

**DEKONSTRUKTIMI I IDESË SË BASHKIMIT:
E ARDHMJA E MARRËDHËNIEVE NË MES KOSOVËS DHE
SHQIPËRISË**

Ky publikim është pjesë e projektit “Shqipëri – Kosovë, Dekonstruktimi i idesë së bashkimit – Perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin mes dy vendeve”. Ky projekt është iniciuar dhe mbështetur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA.

Gjetjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe të kontribuuesve institucionalë. Si të tilla, ato nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Shqipërisë për Shoqëri të Hapur dhe të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.



Përgatitur nga: Lulzim Peci dhe Agon Demjaha, me asistencë të Valdrin Ukshinit.

Copyright © 2020, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +383 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

www.kipred.org

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	4
Hyrje	7
I. Një Shqyrtim i Shkurtër i Historisë së Shqipëtarëve në Kosovë (1913 – 2008)	9
II. Trajtim Kritik i Marrëdhënieve Bilaterale Kosovë – Shqipëri nga Viti 2008	20
III. Konsideratat e Brendshme të Kosovës	31
IV. Konsideratat Ndërkombëtare të Kosovës	41
V. E Ardhmja e Marrëdhënieve Strategjike Kosovë – Shqipëri: Përmbledhje e të Gjeturave dhe Rekomandime	56

Përmbledhje Ekzekutive

Shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë asnjëherë nuk kanë jetuar brenda një administrate të përbashkët dhe unike shtetërore. Në kohën e Perandorisë Osmane ata ishin të ndarë në vilajete të ndryshme, ndërkaq, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe Luftërave Ballkanike, ata jetuan për gati një shekull në dy shtete të ndryshme (Shqipëri dhe Jugosllavi). Mirëpo gjatë këtyre dekadave, Shqipëria rrallë ka treguar një qasje të qëndrueshme dhe përkrahëse ndaj shqiptarëve në Kosovë, qoftë gjatë sundimit të Zogut, apo edhe të Enver Hoxhës. Si pasojë, realitete tërësisht të ndryshme politiko-shoqërore në këto thujse 100 vjet kanë shkaktuar diferenca thujse dramatike mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Në këtë kontekst, nuk duhet nënçmuar rëndësia e nisjes së procesit të formimit të shtetit të Kosovës në ish-Jugosllavi, por edhe natyra e decentralizuar dhe anarkike, nganjëherë madje me synime kontradiktore, e nacionalizmit shqiptar. Diskutimet politike midis politikanëve dhe intelektualëve shqiptarë të Kosovës për marrjen e statusit të një republike brenda Jugosllavisë Federale Socialiste, që kishin filluar rreth gjysmë shekulli më parë, kanë krijuar një identitet të fortë të pavarur politik dhe shtetëror të Kosovës. Në këtë drejtim, është me rëndësi thelbësore të mirret në konsideratë roli që identiteti i dalluar dhe i pavarur politik dhe shtetëror i Kosovës ka luajtur në formësimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Me rënien e Murit të Berlinit ndryshoi edhe konteksti gjeopolitik në Ballkan. Formësimi i orientimit pro-perëndimor i shqiptarëve, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, së bashku me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në 1999, krijuan kushtet për fillimin e një bashkëpunimi midis dy vendeve në një kontekst të ri. Ndërsa me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 kufizimet e bashkëpunimit bilateral u eliminuan, dhe për herë të parë në histori u mundësua zhvillimi i marrëdhënieve midis dy vendeve në nivelin ndërshtetëror.

Në periudhën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, edhe përkundrejt faktit që të dyja vendet kanë objektiv të përbashkët integrimin euro-atlantik, ato operojnë në rrethana të ndryshme ndërkombëtare në raport me proceset integruese. Shqipëria është vend anëtar i NATO-s që nga viti 2009 dhe vend kandidat për BE që nga viti 2014. Ndërsa, në anën tjetër, Kosova vuan nga legjitimiteti i cunguar ndërkombëtar dhe integrimi i limituar në organizatat ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe mos-antarësimin në OKB dhe mosnjohjen nga pesë vende të BE-së, të cilat i limitojnë në një mënyrë drastike perspektivat e saj për integritime Euro-Atlantike.

Megjithate, Përkundrejt mangësive në funksionalitetin shtetëror të dy vendeve, krahas me hapjen e temës së shkëmbimit të territoreve në mes Kosovës dhe Serbisë, ideja e bashkimit mes Kosovës dhe Shqipërisë ka qenë një ndër çështjet më të theksuara në diskursin publik në dy vendet gjatë dy viteve të fundit.

Mirëpo, mundësitë për zbatimin e çfarëdo bashkimi të Kosovës me Shqipërinë në kuadrin e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës janë pothuaj inekzistente, meqë për këtë kërkohet miratimi i komunitetit serb dhe i komuniteteve të tjera joshumicë. Po ashtu, edhe inicimi i referendumit për bashkim nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës është pothuaj i pamundur, meqë edhe në këtë rast do të kërkohet miratimi i komunitetit serb dhe i komuniteteve të tjera joshumicë. Ndërkaq, edhe vendimi për bashkim jashta Kushtetutës mund të merret nga ajo që quhet ‘pouvoir constituant’ (constituent power), e që është fuqia kushtetutë-dhënëse, implikimet politike të ndërmarrjes së një hapi të tillë ekstralegal në situatën e tanishme do të ishin të paparashikueshme, dhe atë posaçërisht sa i përket dimensionit ndër-etnik në Kosovë. Nga ana tjetër, shumica absolute e qytetarëve të Kosovës, nëse duhet të zgjedhin midis bashkimit Kosovë-Shqipëri dhe anëtarësimit në BE, do ta preferonin anëtarësimin në BE, dhe ata po ashtu janë kundër bashkimit, nëse ky do ta kërkonte ndryshimin e kufijve apo ndarjen e Kosovës.

Për më tepër, nëse këto dy vende do të lëviznin në mënyrë të njëanshme dhe pa konsensus të plotë trans-atlantik drejt bashkimit, qoftë me opsionin e absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, qoftë me atë të shkrirjes së tyre në një shtet të përbashkët, atëherë kjo do të kishte pasoja fatale për shtetësinë e Kosovës, dhe do t’i dëmtonte rëndë interesat ekzistenciale dhe vitale të Shqipërisë. Në këtë rast Kosova fare lehtë do të mund të pushonte së ekzistuari si shtet, dhe kjo njëkohësisht do të mund të çonte te vendosja e sanksioneve nga Kombet e Bashkuara, përjashtimin nga NATO, dhe bllokimi i procesit të integritimit apo edhe përjashtimin e Shqipërisë nga BE-ja. Në rrethana të tilla, pos asaj që Kosova dhe Shqipëria pa dyshim që do të konsideroheshin nga Perëndimi si vende matrapaze, të ashtuquajtura “rogue states”, Prishtina dhe Tirana do t’i rrezikonin edhe interesat vitale të Perëndimit në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, përfshirë këtu edhe dobësimin e kohezionit të NATO-s dhe të BE-së.

Nga ana tjetër, iniciativat asociuese midis Kosovës dhe Shqipërisë, që nuk do të krijojnë subjekt të ri të Drejtës Ndërkombëtare, por që do të kishin karakter integruar midis dy vendeve, dhe që do të ishin në linjë me integritet evropian, me politikën e NATO-s dhe me iniciativat bashkëpunuese rajonale, do të mund ta kishin edhe përkrahjen e Brukselit dhe të Washingtonit. Mirëpo, parakusht i

domosdoshëm që iniciativat e tilla asocuese të jenë të dobishme për të dyja vendet, dhe të jenë komplementare e jo në kolizion me politikat e perëndimit në rajon, ato duhet të bëhen në mënyrë transparente me akterët politik dhe civil në të dyja vendet, dhe të konsultuara që më parë me NATO-n dhe me BE-në.

Në këtë aspekt, rritja e kapaciteteve shtetërore të dy vendeve do të përcaktojë progresin jo vetëm të integritimit në strukturat euro-atlantike, por edhe me njëra-tjetrën, dhe do t'i zbehte, si dallimet, ashtu edhe nacionalizmat arkaikë. Padyshim se Kriteret e Kopenhagës dhe aquis i BE-së duhet të shërbejnë si udhërrëfytes të bashkëpunimit ndërshtetëror që çon drejt integritimit. Përmes kësaj qasjeje, fillimisht do të shmangej rreziku i mospërputhshmërisë së marrëveshjeve bilaterale me aquis, dhe do të sigurohej përkrahja e plotë e komunitetit euro-atlantik për bashkëpunimin strategjik mes dy vendeve. Që kjo të realizohet, qeveritë e dy vendeve duhet të krijojnë trupa ndërshtetërore përgjegjëse për harmonizimin e politikave integruese mes tyre.

Në pjesët që nuk mbulohen nga aquis, dhe që kanë të bëjnë me fusha të veçanta të ekonomisë, politikave fiskale, kulturës, rinisë, arsimit, bashkëpunimit ndërkufitar, infrastrukturës strategjike, dhe shkencës, të dy vendet duhet të punojnë së bashku për të krijuar dhe operacionalizuar politika të përbashkëta integruese. Kjo duhet të pasohet me identifikimin dhe lëvrimin e avantazheve përkatëse konkurruese që i ka çdonjëri vend, si dhe me ndërtimin e përbashkët të burimeve njerëzore përmes investimeve në hulumtim dhe zhvillim (R&D) në shërbim të rritjes së konkurrueshmërisë rajonale të dy vendeve.

Ndërkaq, sa i përket bashkëpunimit strategjik midis Kosovës dhe Shqipërisë në politikën e jashtme dhe të sigurisë, për mbrojtjen dhe avancimin e interesave të të dyja vendeve në këto fusha është i domosdoshëm bashkërendimi nën ombrellën e BE-së dhe NATO-s, në konsultim të ngushtë me SHBA-të si dhe vendet e tjera të Quintit (Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia). Që ky bashkëpunim bashkëpunimi strategjik midis Kosovës dhe Shqipërisë të ketë sukses, ai duhet të shoqërohet me projektimin e tyre si shtete kredibile dhe aleatë të besueshëm të Perëndimit.

Hyrje

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912 dhe vendimet e Konferencës së Londrës një vit më vonë, krijuan pakicën më të madhe kombëtare në Evropë, duke lënë jashtë shtetit të sapo krijuar shqiptar gjysmën e territoreve me shumicë shqiptare dhe më tepër se 50% të shqiptarëve që jetonin në rajon. Si rezultat, nacionalizmit shqiptar ju krijuan dy epiqendra pothuajse të pa-subordinuara ndaj njëra tjetrës, gjegjësisht njëra mbeti në Tiranë, ndërsa tjetra u zhvendos tek shqiptarët që mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar, veçanërisht në Kosovë. Një realitetit i tillë politik dhe gjeostrategjik ka ndikuar që gjatë gjithë këtyre viteve çështja e unifikimit të jetë më tepër perceptim emocional dhe sentimental, i shprehur përmes një narrativi populist dhe nacionalist, se sa një çështje e elaboruar hollësisht në Tiranë apo Prishtinë.

Pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999, e sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008, padyshim se janë hapur mundësitë për marrëdhënie shumë më intensive bilaterale mes Shqipërisë dhe Kosovës si dy shtete të pavarura. Megjithatë, përkundër mundësive për intensifikimin e këtyre marrëdhënieve mes dy vendeve në të gjitha fushat, mbizotëron mendimi se bashkëpunimi bilateral në përgjithësi ka qenë më tepër formal dhe emocional, se përmbajtësor dhe në interes të qytetarëve. Kohëve të fundit, ngecja dhe vonimi i procesit të integritit të Shqipërisë dhe Kosovës në Bashkimin Evropian, i ka shtuar tendencat nacionaliste në të dy vendet dhe e ka riaktualizuar çështjen e unifikimit mes dy shteteve. Për më tepër, pakënaqësia me politikën e Bashkimin Evropian karshi të dy vendeve ka nxitur deklarata lidhur me opsionin e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë edhe nga qarqet më të larta në të dy vendet.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, për herë të parë e ka prezantuar idenë projektit për bashkim kombëtar mes Shqipërisë dhe Kosovës gjatë mbledhjes mes qeverive të dy vendeve në nëntor të vitit 2018. Ai me këtë rast i bëri ftesë Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, që dy ministrinë e Jashtme ta nisnin punën për hartimin e një strategjie të përbashkët për bashkimin e shqiptarëve deri në vitin 2025. Nga ana tjetër, i dëshpëruar nga procesi i dialogut me Serbinë, ngecjen në integritet evropiane dhe sidomos me mosliberalizmin e vizave, Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, e inkurajoi Kuvendin e Kosovës dhe atë të Shqipërisë të nxjerrin deklarata për bashkimin mes dy vendeve. Sipas tij, ky bashkim mund të ndodhë nën ombrellën e Bashkimit Evropian, por edhe nën ombrellën shqiptare, në bazë të vullnetit të popullit të Kosovës dhe Shqipërisë për të jetuar në një shtet të

përbashkët. Pa dyshim që ideja për këmbim të territoreve me Serbinë ose për ndarje të Kosovës ka ndikuar që bashkimi mes dy vendeve të shqyrtohet si option i mundshëm për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Qëllim i këtij punimi është ta dekonstruktojë idenë e bashkimit eventual mes Shqipërisë dhe Kosovës duke i analizuar modalitetet e ndryshme të kësaj çështjeje. Për këtë qëllim, në veçanti janë analizuar konsideratat e brendshme dhe ato ndërkombëtare që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në fizibilitetin dhe qëndrueshmërinë e idesë së bashkimit mes dy vendeve. Struktura e punimit përbëhet nga gjithsej gjashtë kapituj, përfshirë hyrjen dhe përfundimin. Pas kapitullit hyrës, në kapitullin e dytë, punimi përqendrohet në një shqyrtim të shkurtër historik të Shqiptarëve të Kosovës gjatë periudhës 1913–2008. Kapitulli i ardhshëm, ofron pikëpamjen e Kosovës të shqyrtimit kritik të marrëdhënieve bilaterale mes Kosovës dhe Shqipërisë pas vitit 2008. Me qëllim të dekonstruktimit të idesë së unifikimit eventual mes Shqipërisë dhe Kosovës, kapitulli i tretë ofron një analizë të hollësishme të konsideratave të brendshme të Kosovës që ndikojnë drejtpërdrejtë në fizibilitetin dhe qëndrueshmërinë e modaliteteve të ndryshme të kësaj çështjeje. Me qëllim të njejtë, në kapitullin e katërt janë analizuar konsideratat ndërkombëtare përmes prizmit të së Drejtës dhe Politikës Ndërkombëtare të bashkimit të dy shteteve sovrane, me theks të veçantë në implikimet e bashkimit të të dyja vendeve në raport me Kombet e Bashkuara (KB), Organizatën e Traktatit Veri - Atlantik (NATO) dhe Bashkimin Evropian (BE). Punimi përfundon me kapitullin përmbyllës, që synon t'i përmbledhë gjetjet kryesore të hulumtimit dhe analizës së bërë.

I. Një Shqyrtim i Shkurtër i Historisë së Shqiptarëve të Kosovës (1913 – 2008)

Dobësimi i Perandorisë Osmane në fund të shekullit të 19-të shënon edhe fillimin e Rilindjes Kombëtare për popujt e Ballkanit të cilët gjatë kësaj periudhe filluan përpjekjet për zgjerimin e tyre territorial kombëtar. Nacionalizmi dhe rilindja kombëtare shqiptare praktikisht u krijuan si reagim mbrojtës ndaj pretendimeve territoriale serbe dhe greke ndaj trojeve shqiptare. Pasi Kongresi i Berlinit nuk i morri parasysh kërkesat e shqiptarëve, në qershor të vitit 1878, rreth 80 delegatë e formuan organozatën e Lidhjes së Prizrenit. Fillimisht, Lidhja kishte për qëllim bashkimin e katër vilajeteve shqiptare dhe pengimin e implementimit të Traktatit të Shën Stefanit që parashihte që tokat me popullatë shqiptare t'i jepeshin Serbisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë. Edhe pse këto kërkesa kishin karakter mbrojtës dhe Lidhja nuk kërkonte krijimin e Shqipërisë së pavarur, Perandoria Osmane e shtypi ate me forcë. Megjithate, Lidhja e Prizrenit paraqet rezistencën e parë të shqiptarëve kundër politikave ekspansioniste të shteteve fqinje të Ballkanit dhe tentativën e parë për të bashkuar lëvizjen kombëtare shqiptare drejt arritjes së qëllimit për një Shqipëri të pavarur. Poashtu, Lidhja ndihmoi në zhvillimin e mëtutjeshëm kombëtar shqiptar, që gjithsesi pastaj kontriboi në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912.

Padyshim se ndarja fizike mes shqiptarëve në Shqipëri dhe në Kosovë, që ishte pasojë e Luftërave Ballanike dhe Konferencës së Londrës më 1913, ka krijuar dallime të theksuara në mentalitetin, kulturën dhe distancën mes dy popujve.¹ Me konfirmimin e kufijve që pak a shumë Shqipëria i ka edhe sot, Konferenca e verifikoi ekzistencën e shtetit shqiptar, por njëkohësisht e krijoi edhe pakicën më të madhe në Evropë, sepse shteti i sapo krijuar shqiptar përfshiu jo më shumë se 50% të territoreve me shumicë shqiptare, ndërkaq që më shumë shqiptarë mbetën jashtë shtetit se brenda tij. Shumica e zonave të banuara me shqiptarë ju dhanë Serbisë dhe Malit të Zi, ndërsa Greqia mori rajonin e madh jugor, të njohur si Epiri i Veriut nga Greqia, apo si Çamëri nga Shqipëria.²

Edhe pse shqiptarët e Kosovës e bënë shumicën e kryengritjeve për krijimin e shtetit shqiptar, përkundër vullnetit të tyre Kosova mbeti nën sundimin e Serbisë dhe jashtë kufijve të shtetit të sapo krijuar të Shqipërisë. Si rezultat, nacionalizmit shqiptar ju krijuan dy epiqendra, gjegjësisht njëra

¹ Intervistë me Hajredin Kuçin, Nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe ish Zëvendës-Kryeministër i Kosovës, Prishtinë, 27.05.2019.

² Tom Gallagher, *Outcast Europe: The Balkans, 1789-1989*, London: Routledge, 2001, f. 64.

mbeti në Tiranë, ndërsa tjetra u zhvendos tek shqiptarët që mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar, veçanërisht në Kosovë. Rrjedhimisht, dallimet gjatë këtyre dekadave si rezultat i dy realiteteve tërësisht të ndryshme politiko shoqërore kanë shkaktuar diferenca të mëdha mes Kosovës dhe Shqipërisë, që herë-herë janë madje edhe dramatike.³ Po ashtu, duhet theksuar që shqiptarët në Kosovë betejën politike e kanë bërë në rend të parë për mbijetesë si entitet politik dhe për ruajtjen e demografisë në favor të shumicës shqiptare. Përderisa në Shqipëri prioritet kryesor ka qenë konsolidimi i shtetit të pavarur, dhe më pas mirëqenia socio-ekonomike, në Kosovë synimi parësor ka qenë mbijetesja personale dhe kombëtare.⁴ Nga ana tjetër, në Shqipëri ka mbizotëruar më tepër një betejë ideologjike brenda vendit që në masë të madhe është karakterizuar me ndarje politike që janë prezente edhe sot.⁵ Për më tepër, siç do të shihet më poshtë, këto rrethana kanë ndikuar që shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë t'i përjetojnë ndryshe edhe ngjarjet e njëjta të momenteve kryesore të historisë së shekullit 20. Kështu, edhe vetë pavarësia e Shqipërisë, për shqiptarët që jetonin brenda kufijve të shtetit të ri ishte përjetuar si çlirim, ndërkaq që për shqiptarët e Kosovës, mbetja nën Serbi ishte vazhdim i robërisë, madje edhe më të dhunshme se gjatë Perandorisë Otomane.

Periodha kohore në mes të krijimit të shtetit shqiptar dhe Luftës së Parë Botërore, karakterizohet me rritjen e nacionalizmit të shqiptarëve të Kosovës përmes revoltave të përgjithshme ndaj fuqisë ushtarake të Serbisë dhe më vonë edhe ndaj Bullgarisë (1915-1918). Qëllimi kryesor ishte bashkimi i territoreve të zonave kulturore shqiptare të lëna jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë me ato të Shqipërisë.⁶ Nacionalistët shqiptarë u organizuan kryesisht rreth Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, i cili në një formë të shthurur kishte ekzistuar qysh prej majit të vitit 1915. Ky komitet ishte themeluar në Shkodër me qëllim primar për të bërë fushatë kundër vendimit për caktimin e kufijve të Konferencës së Ambasadorëve, me fjalë të tjera për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e të gjitha tokave të banuara me shqiptarë. Një objektivë tjetër ishte edhe organizimi i sulmeve kundër Serbisë dhe kontrabandimi i armëve për kryengritësit në kufi. Kur më 1 dhjetor 1918 u krijua Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve – e quajtur jo-formalisht si Jugosllavi – përkundrejt vullnetit të tyre, një pjesë shumë e madhe e popullit shqiptar u integrua në shtetin e Serbisë dhe Malit të Zi nën kushte veçanërisht të dhunshme. Pjesa më e madhe e periudhës midis dy luftërave

³ Intervistë me Agron Bajramin, Kryeredaktor i gazetës Koha Ditore, Prishtinë, 10.06.2019.

⁴ Intervistë me Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

⁵ Intervistë me Jetlir Zyberaj, Këshilltar i Ministrisë të Jashtëm të Kosovës, Prishtinë 21.06.2019.

⁶ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019.

botërore karakterizohet me periudha të rezistencës së armatosur shqiptare kundër autoriteteve serbe dhe me politikat shtypëse të qeverisë së Serbisë. Rezistenca e armatosur udhëhiqej nga Komiteti Kosovar, ndërsa në mesin e kryengritësve që njiheshin si kaçakë ishin aktivë një varg patriotësh të shquar nga Kosova, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Azem Bejta dhe Shote Galica.⁷

Serbët besonin se ishte veçanërisht e padëshirueshme që shqiptarët të arsimoheshin në gjuhën shqipe, nga frika se lidhjet gjuhësore do të mund ta ushqenin nacionalizmin shqiptar. Pikërisht, asimilimi gjuhësor ishte pjesë e tendencës për të serbizuar rajonin, një ideologji kjo e cila ishte planifikuar madje edhe para Luftës së Parë Botërore. Rrjedhimisht, autoritet serbe mbyllën të gjitha shkollat shqipe, të cilat ishin hapur në kohën e Perandorisë Austro-Hungareze në periudhën e Luftës së Parë Botërore.⁸ Në vend të tyre, institucionet e vetme arsimore që u lejuan nga regjimi serb ishin shkollat fetare, si ato islamiket, ashtu edhe ato katoliket. Është e qartë që autoritet serbe ishin të prirura të theksojnë më shumë prapavijën fetare se atë etnike të shqiptarëve të Kosovës.⁹

Për më tepër, në vitin 1937, Vaso Çubrilloviq propozon që shqiptarët të riklasifikohen si “turq,” duke i shtrënguar të emigronin dhe duke ua bërë jetën në Kosovë të padurueshme dhe të mjerë. Me qëllim të ndryshimit të realitetit etnik në Kosovë, Serbia ndërmorri të ashtuquajturën “reformë agrare” për t’i shpronësuar dhe për t’i larguar shqiptarët nga Kosova dhe për ta kolonizuar Kosovën me bujq sllavë. Për këtë qëllim, në vitin 1938, u nënshkrua Marrëveshja Turko-Jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, e cila parashihte që për në Turqi të shpërnguleshin rreth 250 mijë myslimanë. Fakti që popullsia e qyteteve u përjashtua nga shpërngulja, dëshmon qartë se qëllimi kryesor ishte shpërngulja e shqiptarëve, meqë në qytete jetonte kryesisht popullata me kombësi turke.¹⁰ Si rrjedhojë, gjatë periudhës deri në vitin 1939, më tepër se gjysmë milion shqiptarë etnikë ishin detyruar të emigronin nga ky rajon, ndërsa përafërsisht 40,000 qytetarë sllavë ortodoksë ishin shpërngulur në Kosovë, duke u dhënë tokë falas dhe përfitime të tjera.¹¹ Duhet theksuar se çështja e Kosovës dhe zonave të tjera të banuara nga shqiptarët ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në politikat e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë para marrjes së pushtetit nga ana e Ahmet

⁷ Noel Malcolm, *Kosova: Një Histori e Shkurtër*, New York: New York University Press, 1998, f. 283-286.

⁸ Henry Perritt Jr, *The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Abtisaari Plan*, Cambridge: Cambridge University Press, 2010, f. 18.

⁹ Ina Merdjanova, *Rediscovering the Umma: Muslims in the Balkans between Nationalism and Transnationalism*, Oxford University Press, 2013, f. 43.

¹⁰ Shkëlzen Gashi, *Historia e Kosovës në tekstat mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni*, Prishtinë: Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë “Alter Habitus”, 2016, f. 83.

¹¹ Hugh Poulton, *Who Are the Macedonians?*, London: Hurst, 1995, f. 91.

Zogut.¹² Mirëpo, gjatë fazës së parë të sundimit të Zogut, Kosova le që nuk luante ndonjë rol të rëndësishëm në politikën e jashtme shqiptare, por gjatë kësaj periudhe Zogu ishte aleat i ngushtë i Serbisë dhe armik i përbetuar i kryengritësve shqiptarë. Vetëm pas vitit 1928, kur Shqipëria u vu në masë të madhe nën vartësinë italiane, Zogu u detyrua ta luante kartën irredentiste në Kosovë, meqë Musolini ishte tejet i interesuar për ta destabilizuar Jugosllavinë.¹³

Periudha e Luftës së Dytë Botërore, ishte e vetmja gjatë të cilës Shqipëria dhe Kosova përjetuan një histori të shkurtër unifikimi (1941-1944), dhe atë nën pushtimin fashist. Ndonëse ky bashkim ishte produkt i dinamikës gjeopolitike të fuqive të boshët, kjo periudhë konsiderohet si e vetmja gjatë të cilës dy vendet u bashkuan në një shtet të centralizuar shqiptar. Për më tepër, në këtë periudhë për herë të parë u hapën edhe shkolla në gjuhën shqipe në tërë territorin e Kosovës me qëllim të rritjes së nivelit të shkollimit dhe të vetëdijes kombëtare në mesin e popullatës shqiptare.¹⁴ Është interesante se kjo kohë solli edhe përfitime ekonomike dhe përmirësim të perspektivës ekonomike të të dyja vendeve. Kështu, vetëm gjatë vitit 1942, njëzet mijë ton grurë dhe tridhjetë mijë ton misër u eksportuan në Shqipëri nga Kosova, duke siguruar kështu një tepricë të konsiderueshme të produkteve bujqësore.¹⁵ Mirëpo, edhe këtë periudhë historike, shqipëtarët në të dy anët e kufirit e përjetuan në mënyra të ndryshme. Pushtimi fashist në Shqipëri, që formalisht ishte vend i lirë dhe sovran, është përjetuar më shumë si okupim. Ndërkaq në Kosovë dhe trevat e tjera shqiptare nën thundrën e Mbretërisë Jugosllave, ky pushtim është përjetuar si çlirim. Kjo për faktin se meqë jetonin në dy realitete të ndryshme politike, shqiptarët në Shqipëri dhe në Kosovë kishin përceptime të ndryshme për realitetin ekzistues, përfshirë këtu edhe vetë lirinë kombëtare. Përderisa në Shqipëri luftonin kundër okupimit, në Kosovë qytetarët kryesisht i gëzoheshin çlirimit nga Serbia.¹⁶

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore shqiptarët e Kosovës mbetën pjesë e Jugosllavisë socialiste edhe përkundrejt premtimeve që do t'i bashkoheshin Shqipërisë nëse do të mbështetnin partizanët për t'i luftuar forcat okupatore. Rrjedhimisht, në mbledhjen e komunistëve kosovarë në Bujan, u nxorr rezoluta që thoshte se lufta kundër pushtuesve gjermanë është mënyra më e mirë për ta zgjidhur

¹² Fillimisht si presidenti i parë (1925-1928) dhe pastaj si mbret i Shqipërisë (1928-1939).

¹³ Për një spjegim të detajuar lidhur me qëndrimin e Ahmet Zogut ndaj Kosovës shih Malcolm, 1998, f. 288-300.

¹⁴ Për ilustrim, para luftës në Kosovë ishin 252 shkolla me mësim vetëm në serbisht. Nga fundi i vitit 1945 funksiononin 392 shkolla, me 357 klasë në serbisht dhe 279 klasë në gjuhën shqipe. Shih Malcolm, 1998, f. 331.

¹⁵ Dritan Sulçebe, *Shqipëria dhe Kosova në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët*, Tiranë: Friedrich-Ebert-Stiftung, 2016, f. 15.

¹⁶ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkryetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019.

çështjen kombëtare, pra bashkimin me Shqipërinë, sipas parimit të vetëvendosjes.¹⁷ Mirëpo, në korrik të vitit 1945, në Konferencën e Këshillit Nacional-Çlirimtar të Kosovës në Prizren, ku merrnin pjesë 142 anëtarë, prej tyre vetëm 33 shqiptarë, u miratua një rezolutë sipas të cilës Kosova njihet si pjesë e Sërbisë.¹⁸ Për më tepër, shqiptarët e Kosovës në Jugosllavinë socialiste arritën të njihen vetëm si kombësi dhe jo si komb, pasi që "atdheu" kombëtar shqiptar ishte jashtë territorit të Jugosllavisë.¹⁹ Përveç kësaj, edhe pse në bazë të regjistrimit civil të kryer në vitin 1948 serbët dhe malazezët përbënin vetëm 27.5 për qind të popullsisë së Kosovës, të gjitha institucionet e Kosovës, dhe në veçanti shërbimet e sigurisë, dominoheshin nga serbët dhe malazezët.²⁰ Duhet theksuar se gjatë periudhës (1945-1948) Shqipëria kishte marrëdhënie të mira me Jugosllavinë dhe madje mbante qëndrimin se kosovarët duhej të vëllazëroheshin me jugosllavët. Një kahje të tillë të politikës të Hoxhës e evidentoi edhe Joseph E. Jacobs, Shefi i parë të Misionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, i cili në njërin nga raportimet e tij theksoi se edhe pse "ka rreth gjysmë milion shqiptarë në zonën e Kosovës të Jugosllavisë," autoritetet shqiptare e pranuan qëndrimin e Jugosllavisë se nuk duhet të ketë ndonjë ndryshim të kufijve mes dy vendeve. Sipas mendimit të tij, kjo ishte për shkak të ndikimit të madh që Josip Broz Tito ushtronte mbi Tiranën.²¹ Për më tepër, pikësynimi i atëhershëm afatgjatë i Enver Hoxhës ishte ta bashkonte Shqipërinë me Jugosllavinë dhe Bullgarinë në një "Federatë Ballkanike". Ndarja e Titos nga Stalini në vitin 1948 rezultoi në ndërprerjen e plotë të bashkëpunimit mes dy vendeve dhe mbylljen hermetike të kufirit, ndërkaq që Enver Hoxha u bë kritik i zhurmshëm i politikave të Titos.²²

Pasojat më të dëmshme, sidomos në rrafshin politik, të prishjes së marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi i vuajtë Kosova. Pushteti jugosllav i mbylli shumicën e shkollave shqipe që ishin hapur menjëherë pas çlirimit, si dhe i ndaloi simbolet dhe festat kombëtare shqiptare.²³ Gjatë viteve 1950 u shtua edhe më tepër represioni kundër shqiptarëve përmes fushatave për çarmatimin e popullsisë, me ç'rast banorët shqiptarë merreshin në pyetje dhe rraheshin në polici. Sërisht shqiptarët u inkurajuan që të

¹⁷Shkëlzen Gashi, Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mali i Zi dhe Maqedoni, Prishtinë: Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë "Alter Habitus", 2016, f. 92.

¹⁸Noel Malcolm, Kosova: Një Histori e Shkurtër, New York: New York University Press, 1998, f. 328-329.

¹⁹Dennison Rusinow, *The Yugoslav Experiment 1958-1974*. Berkeley and Los Angeles: University of California Press, 1977, f.188.

²⁰Tim Judah, *Kosovo: What Everyone Needs to Know*, Oxford: Oxford University Press, 2008, f. 51.

²¹Bekim Sejdiu & Luzim Peci (2017): Engaging with the self-captive nation: Albania in the US official documents from 1945 to 1980, Southeast European and Black Sea Studies, Volume 18, Issue 1, 2018, 89.

²²Për detaje shih Noel Malcolm, Kosova: Një Histori e Shkurtër, New York: New York University Press, 1998, f. 332-334.

²³Shkëlzen Gashi, Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mali i Zi dhe Maqedoni, Prishtinë: Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë "Alter Habitus", 2016, f. 93.

identifikoheshin si “turq”, duke hapur sërish shkolla të reja turke. Në të njëjtën kohë, në vitin 1953, u nënshkrua një traktat qeveritar me Turqinë me anë të të cilit turqit e Jugosllavisë lejoheshin të emigronin. Një gjë e tillë bëri që të shpërthejë një eksod masiv drejt Turqisë, ku shumë shqiptarë dhe sllavë myslimanë u detyruan të shkruheshin si turq, në mënyrë që të ishin në gjendje ta lëshonin vendin e tyre.²⁴ Si rrjedhojë, u rrit nacionalizmi shqiptar në Kosovë dhe pjesë të tjera të Jugosllavisë, si reagim ndaj diskriminimit të madh etnik për shkak të krijimit të republikave kombëtare siç ishin Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi mbi premisat ekskluzive etno-linguistike. Politikat e tilla diskriminuese i ndihmuan edhe rritjes së vetëdijes për një identitet shqiptar dhe për promovimin e një solidariteti mbarë-shqiptar në ish-Jugosllavi. Gjatë gjithë kësaj periudhe, populli shqiptar u organizua për t’iu kundërpërgjigjur dhunës së pashembullt serbe dhe kthimit të Kosovës nën Sëri. Organizata kryesore e shqiptarëve të Kosovës ishte Komiteti Nacional Demokratik i Shqiptarëve (NDSH), e cila synonte çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë.²⁵

Situata ndryshoi për të mirë në vitin 1966, kur në plenumin partiak në Brione u shkarkua shefi famëkeq i shërbimit sekret të UDB-së, Aleksandar Ranković. Pasuan një varg masash për përmirësimin e pozitës së shqiptarëve, sidomos pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1968. Emërtimi zyrtar i krahinës u ndryshua nga “Kosovë-Metohi” në “Kosovë”, ndërkaq që krahinat u përcaktuan si bashkësi politiko-shoqërore, njësoj si republikat, me çka Kosova bëhej entitet legjitim i nivelit federativ që kishte të drejtë të ushtronte pothuaj të gjitha kompetencat e një republike. Mirëpo, shqiptarët nuk ishin të kënaqur me këto masa gjysmake, kështu që në vitin 1968 organizuan demonstrata ku u brohorit “Kosova Republikë”, “Duam Universitet”, “Rroftë Shqipëria”, dhe “Rroftë Enver Hoxha”. Edhe pse demonstratat u shtypën me dhunë, në periudhën në vazhdim pozita e shqiptarëve në Kosovë u përmirësua edhe më tepër përmes miratimit të një vargu të ri amendementesh kushtetuese. Ndër tjera, prej vitit 1969 shqiptarëve në Kosovë iu lejua përdorimi i flamurit shqiptar, ndërkaq që në vitin 1970 u hap edhe Universiteti i Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe ndodhi edhe përafrimi mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, meqë nga vdekja e Stalinit në vitin 1953 kishte ndodhur edhe përmirësimi i raporteve mes Titos dhe Hrushçovit. Rrjedhimisht, në vitin 1970, Universiteti i Prishtinës nënshkroi një marrëveshje me atë të Tiranës për angazhimin e 200 profesorëve nga Tirana për të ligjëruar në gjuhën shqipe në Kosovë për një periudhë pesë vjeçare.²⁶

²⁴ Sipas burimeve jugosllave, gjatë kësaj periudhe rreth 80,000 njerëz kishin emigruar, ndërsa në bazë të burimeve të Turqisë shifra arrin në 150,000; Merdjanova, 2013, f. 43.

²⁵ Shkëlzen Gashi, Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sëri, Mali i Zi dhe Maqedoni, Prishtinë: Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë “Alter Habitus”, 2016, f. 93.

²⁶ Noel Malcolm, Kosova: Një Histori e Shkurtër, New York: New York University Press, 1998, f. 338-340.

Njëkohësisht u shtua hovshëm edhe bashkëpunimi në fushat e tjera, ndërkaq që në vitin 1972 në “Kongresin e Drejtshkrimit” u bë edhe unifikimi i gjuhës shqipe si parakusht thelbësor për rikrijimin e një identiteti të përbashkët të të gjithë shqiptarëve në Ballkan.²⁷

Një avancim edhe më i madh i pozitës kushtetuese të Kosovës ndodhi me Kushtetuten e Jugosllavisë të vitit 1974, me të cilën krahinat autonome të Kosovës dhe të Vojvodinës fituan një status thuajse të barabartë me republikat dhe kishin përfaqësuesit e tyre të drejtpërdrejtë në forumet kryesore të Jugosllavisë. Kushtetuta e vitit 1974 gjithashtu ju ofronte qeverive lokale ingerenca për vetë-qeverisje, që nënkuptonte të drejtën e të gjithë popujve të Jugosllavisë për të krijuar shoqata shoqërore, kulturore, fetare, dhe sportive në gjuhët e tyre përkatëse me qëllim të kultivimit të trashëgimisë së tyre kulturore. Në përgjithësi, vitet pas Kushtetutës Jugosllave të vitit 1974 janë konsideruar nga shqiptarët në Jugosllavi si një epokë e artë. Ata ishin më të lirë, më të arsimuar dhe me standard më të lartë se sa kishin qenë gjatë gjithë historisë së tyre. Mirëpo, edhe përkundrejt avancimit të dukshëm të pozitës së saj, Kosova si krahinë nuk e kishte një të drejtë jashtëzakonisht të rëndësishme në krahasim me republikat në Jugosllavi - të drejtën e shkëputjes nga federata. Rrjedhimisht, në vitin 1981 shpërthyen një varg demonstratash të shqiptarëve që sërish kërkonin ngritjen e statusit të Kosovës në republikë. Demonstratat u shtypën brutalisht nga forcat speciale të policisë; në tërë Kosovën u shpall gjendje e jashtëzakonshme, dhe një numër i madh i shqiptarëve, kryesisht të rinjë, morrën dënime të gjata në burg. Edhe pse zyrtarisht numri i viktimave gjatë këtyre përleshjeve ishte 57, ka gjasa që shifra e vërtetë të ishte mbi njëqind. Gjatë tetë viteve të ardhshme, më shumë se gjysmë milion shqiptarë të Kosovës ose ishin arrestuar ose u morrën në pyetje,²⁸ ndërkaq që në këtë periudhë 80% e të burgosurve politikë në Jugosllavi ishin shqiptarë.²⁹ Njëkohësisht, sërish u përkeqësuan marrëdhëniet me Shqipërinë, u ndërpre çdo lloj bashkëpunimi në të gjitha fushat, përfshi edhe atë mes Universitetit të Prishtinës dhe atij të Tiranës.

Suprimimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe politikat represive dhe nacionaliste të Slllobodan Millosheviqit në Kosovë, i përkeqësuan edhe më tepër marrëdhëniet serbo-shqiptare. Shqiptarët reagojnë ndaj shtypjes së autonomisë së Kosovës me anë të protestave masive në gjithë krahinën. Mijëra njerëz dolën që të marrin pjesë në demonstrata, të cilat u shpërndanë me dhunë nga forcat speciale, duke rezultuar me vrasjen e 29 protestuesve dhe plagosjen e 97 civilëve dhe të 30

²⁷ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 10.06.2019.

²⁸ Tim Judah, Kosovo: What Everyone Needs to Know, Oxford: Oxford University Press, 2008, f. 58.

²⁹ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019.

policëve.³⁰ Këto protesta etnike u mbështetën fuqishëm nga intelektualët shqiptarë, studentët dhe qytetarët e thjeshtë nga e gjithë Kosova, shumica e të cilëve ishin arrestuar dhe më vonë ishin gjykuar. Më 5 korrik 1990, Kuvendi i Serbisë shpërndau Kuvendin e Kosovës si dhe Këshillin Ekzekutiv Krahinor të Kosovës, duke marrë kontrollin e plotë dhe të drejtpërdrejtë të krahinës. E tërë struktura e administratës krahinore u shpërnda dhe praktikisht brenda natës shqiptarët u larguan nga vendet e tyre të punës, ju mohua e drejta për arsimim në gjuhën e tyre amtare dhe ju eksponuan një abuzimi masiv të të drejtave të njeriut dhe lirive civile.³¹

Duhet theksuar se gjatë Luftës së Ftohtë, marrëdhëniet midis Tiranës dhe Beogradit, ishin më tepër të përcaktuara nga armiqësitë dhe përçarjet ideologjike brenda kampit komunist, sesa nga qëllimet nacionaliste. Në këtë drejtim, është interesant se gjatë kësaj periudhe, synimet politike të shqiptarëve të Kosovës për krijimin e një republike brenda ish Jugosllavisë u kundërshtuan edhe nga Beogradi edhe nga Tirana. Në Shqipëri, zgjidhja e çështjes së Kosovës shihej në prizmin e luftës marksiste-leniniste për çlirim kundër "klikës së Titos", dhe për më tepër, ekzistonte frika se "Republika e Kosovës" mund të përdorej si mjet për nxitjen e ndryshimit të regjimit në Tiranë.³² Prandaj, nuk është për t'u habitur që ambiciet e shqiptarëve të Kosovës për krijimin e një republike brenda Jugosllavisë Socialiste, nga Enver Hoxha u etiketuan si "Shovinizëm kosovar".³³

Rrënimi i Murit të Berlinit dhe disfata e komunizmit mundësuan pluralizmin politik edhe në ish-Jugosllavi. Kështu, në dhjetor të vitit 1989 u formua Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me kryetar Ibrahim Rugovën, që kishte për qëllim të organizonte kundërshtimin paqësor të shqiptarëve dhe internacionalizimin e çështjes së Kosovës. LDK-ja angazhohej për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi në bazë të parimit të vetëvendosjes. Më 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës shpalli Deklaratën Kushtetuese, sipas të cilës Kosova fitonte statusin e republikës në kuadër të federatës jugosllave, ndërsa më 7 shtator 1990 u shpall edhe Kushtetuta e

³⁰ Sipas shifrave zyrtare 24 shqiptarë ishin vrarë gjatë këtyre demonstratave, shënimet jozyrtare thonë se 70 demonstrues ishin vrarë.

³¹ Shfuqizimi i autonomisë së Kosovës u pasua nga një sërë aktesh ligjore, të vlefshme vetëm për territorin e Kosovës, me anë të të cilave shqiptarëve të Kosovës iu privuan shumë të drejta themelore të njeriut. Ato përfshinin Aktin për Marrëdhënie Pune në Rrethana të Veçanta, Aktin e Arsimit, dhe Aktin e Kufizimit të Transaksioneve për Patundshmëri. Si rezultat i kësaj prej 170,000 shqiptarëve të punësuar në sektorin publik, 115,000 u larguan nga puna. Akti i Arsimit kishte dëbuar pothuaj gjysmë milioni të rinj shqiptarë nga sistemi arsimor shtetëror; shih Muhamedin Kullashi, "Kosovo and Disintegration of Yugoslavia," në editorialet e Dušan Janjić dhe Shkelzen Maliqi, eds., *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian Relations and Integration of the Balkans*, Subotica: Open University, 1994, f. 183.

³² Për një spjegim më detaj, shih për shembull Et'hem Çeku, "Kosovo during the tense relations between Albania and Yugoslavia in sixties and seventies of the twentieth century," *International Relations Quarterly*, Vol. 5, No.2, (Verë 2014).

³³ Ibid. f.16

Kosovës.³⁴ Pas dezintegrimit të ish-Jugosllavisë, më 26 shtator 1991, u mbajt referendumi për shpalljen e Kosovës shtet i pavarur, në të cilin pothuaj 100% e popullatës shqiptare të Kosovës votuan pro pavarësisë.³⁵ Pas formimit edhe të partive të tjera politike, më 24 maj 1992 në Kosovë u mbajtën zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, dhe u krijua qeveria e udhëhequr nga LDK-ja.

Me këtë rast, duhet të theksohet se rezistenca e paqësore e shqiptarëve në Kosovë fillimisht u përkrah nga Kuvendi i Shqipërisë me deklaratën e 21 tetorit 1991 për përkrahje të pavarësisë Kosovës, mirëpo ky kurs politik i Tiranës formalisht mori kahje tjetër pas më pak se tri viteve. Kështu në vitin 1994, Qeveria e Shqipërisë e drejtuar nga Partia Demokratike deklaroi se Kosova është çështje e brendshme e Jugosllavisë. Pozicionin e njejtë e ndoqi edhe Kryeministri socialist Fatos Nano, i cili, pas takimit të nëntorit 1997 me Milošević në Kreta, deklaroi se Kosova është një çështje e brendshme e të drejtave të njeriut të Serbisë.³⁶

Ndërkohë, përderisa shqiptarët të udhëhequr nga Ibrahim Rugova, përmes rezistencës paqësore mundoheshin ta bindin botën që e meritojnë lirinë, dhuna e shtuar serbe në Kosovë po bëhej e padurueshme. Si rezultat i këtij represioni të vazhdueshëm, në vitin 1997 në skenë u shfaq Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) e cila kishte për qëllim mbrojtjen e popullatës civile dhe çlirimin e Kosovës nga forcat policoro-ushtarake të Serbisë. Si pasojë, nga shkurti i vitit 1998, në Kosovë filloi një konflikt i armatosur i një shkalle të gjerë mes UÇK-së dhe forcave të policisë speciale dhe njërive të rregullta të ushtrisë jugosllave.³⁷ Për të parandaluar krimet e forcave serbe ndaj popullatës civile dhe spastrimin etnik të shqiptarëve, më 24 mars 1999, NATO ndërhyri ushtarakisht kundër Serbisë. Më 10 qershor 1999, pas 78 ditësh të bombardimeve të NATO-s të caqeve ushtarake serbe, u arrit “Marrëveshja teknike-ushtarake e Kumanovës” dhe tërheqja e forcave të Serbisë nga territori i Kosovës. Pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, më 10 qershor 1999, miratoi Rezolutën 1244, me të cilën edhe formalisht Kosovën e vendosi nën administrimin e Kombeve të Bashkuara.

³⁴ Shkëlzen Gashi, Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mali i Zi dhe Maqedoni, Prishtinë: Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë “Alter Habitus”, 2016, f. 103.

³⁵ Marie-Janine Čalić, “Kosovo in the twentieth century: A Historical Account,” në Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, eds., *Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship*, Tokyo: United Nations University Press, 2000, f. 22.

³⁶ Dr. Ilir Kalemaj, Marrëdhëniet Kosovë – Shqipëri: Quo Vadis? Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë, 2014

³⁷ Agon Demjaha dhe Lulzim Peci, “Interethnic Relations in the Western Balkans Implications for Kosovo.” Policy Paper No. 6/14, Kosovar Institute for Policy Research and Development (KIPRED), dhjetor 2014, f. 23.

Duhet theksuar që gjatë periudhës 1998-1999, nga Kosova u larguan rreth 900,000 shqiptarë, që kryesisht u strehuan në Shqipëri dhe Maqedoni, por edhe në Mal të Zi dhe vende të tjera në Europë dhe botë. Në Shqipëri ishin strehuar 444.600 shqiptarë nga Kosova të cilët qëndruan atje deri në përfundimin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në qershor të vitit 1999. Njëkohësisht, gjatë gjithë konfliktit në Kosovë, Shqipëria i dha një mbështetje të konsiderueshme Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shërbeu si një "bazë jashtë vendit" për njësitë e saj dhe strukturën komanduese³⁸. Përfundimi i luftës mundësoi fillimin e një epoke të re, meqë pas pothuaj një gjysmë shekulli izolimi të plotë, Shqipëria dhe Kosova kishin mundësinë të për afrohen dhe kështu u krijua mundësia për arritje të rëndësishme në çdo fushë të bashkëpunimit mes dy vendeve. Nga ana tjetër, me përfundimin e luftës në Kosovë dhe vendosjen e Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për herë të parë që nga pavarësia, Shqipëria praktikisht pushoi të ndajë kufirin e saj ndërshtetëror me Serbinë, çka solli një ndryshim të madh gjeopolitik edhe të marrëdhënieve në trekëndëshin Beograd - Prishtinë – Tiranë. Pastaj në vitin 2008, shpallja e pavarësisë së Kosovës jo vetëm se i dha një impuls shtesë marrëdhënieve mes Kosovës dhe Shqipërisë që tani filluan të zhvillohen si marrëdhënie ndër-shtetërore, por edhe i vulosi përfundimisht marrëdhëniet në trekëndëshin Beograd - Prishtinë – Tiranë.³⁹ Pavarësia e Kosovës njëkohësisht ishte një moment historik të cilin shqiptarët në të dy vendet e përjetuan në mënyrë të njëjtë – si çlirim përfundimtar të një pjese të kombit shqiptar. Njëkohësisht, pavarësia e Kosovës ka hapur horizonte të reja të bashkëpunimit midis dy shteteve të pavarura pothuajse në të gjitha fushat.

³⁸ Pandeli Majko, (ish-Kryeministër i Shqipërisë), Opinion: Lufta në Kosovë [Opinion: War in Kosovo], , TV KLAN, Tiranë, 27. 03. 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=eyU3FQSDyZU>

³⁹ Dritan Sulçebe, *Shqipëria dhe Kosova në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët*, Tiranë: Friedrich-Ebert-Stiftung, 2016 f. 17.

- **Konkluzione**

Nga analiza e mësipërme mund të përfundohet që historia paralele mes shqiptarëve në Kosovë dhe Shqipëri pas vitit 1913 ka krijuar dallime të theksuara në mentalitetin, kulturën dhe distancën mes dy popujve. Jeta në dy Jugosllavitë, për shqiptarët e Kosovës kryesisht ishte tejet e vështirë, meqë ata persekutoheshin, u mohoheshin të drejtat kombëtare dhe detyroheshin me dhunë t'i lëshojnë trojet e tyre. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ata nuk kanë rreshtur në përpjekjet e tyre për afirmimin e vlerave kombëtare dhe bashkimin eventual me Shqipërinë. Mirëpo gjatë këtare dekadave, Shqipëria rrallë ka treguar një qasje të qëndrueshme dhe përkrahëse ndaj shqiptarëve në Kosovë, qoftë gjatë sundimit të Zogut, apo edhe të Enver Hoxhës. Si pasojë, realitete tërësisht të ndryshme politiko-shoqërore në këto thuajse 100 vjet kanë shkaktuar diferenca thuajse dramatike mes Kosovës dhe Shqipërisë. Në këtë kontekst, nuk duhet nënçmuar rëndësia e procesit të formimit të shtetit të Kosovës në ish-Jugosllavi, por edhe natyra e decentralizuar dhe anarkike, nganjëherë madje me synime kontradiktore, e nacionalizmit shqiptar. Në këtë drejtim, është me rëndësi thelbësore të mirret në konsideratë roli që identiteti i dalluar dhe i pavarur politik dhe shtetëror i Kosovës ka luajtur në formësimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Shqipërisë. Diskutimet politike midis politikanëve dhe intelektualëve shqiptarë të Kosovës për marrjen e statusit të një republike brenda Jugosllavisë Federale Socialiste, që kishin filluar rreth gjysmë shekulli më parë, kanë krijuar një identitet të fortë të pavarur politik dhe shtetëror të Kosovës. Të kuptuarit e tipareve të pavarësisë politike dhe shtetndërtimit në Kosovë, që u forcuan me rezistencën paqësore dhe luftën për pavarësi, dhe u galvanizuan me shpalljen e pavarësisë në vitin 2008, është e një rëndësie thelbësore për të kuptuar jo vetëm marrëdhëniet midis Tiranës dhe Prishtinës, por edhe të marrëdhënieve Shqiptaro-Serbe në përgjithësi. Ishte përfundimi i luftës në Kosovë në vitin 1999 ai që e mundësoi përafrimin e shqiptarëve të dy vendeve pas pothuaj një gjysmë shekulli izolimi të plotë. Pavarësia e Kosovës në vitin 2008 hapi horizonte të reja për një bashkëpunim intensiv mes dy vendeve. Rrugëtimet e ndryshme gjatë historisë të shqiptarëve në të dy vendet padyshim se janë të një rëndësie të veçantë për t'i kuptuar drejtë marrëdhëniet e tanishme dhe të ardhshme mes Kosovës dhe Shqipërisë.

II. Trajtim kritik i marrëdhënieve bilaterale mes Kosovës dhe Shqipërisë nga viti 2008: Pikëpamja e Kosovës

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt të vitit 2008, janë hapur mundësitë për marrëdhënie shumë më intensive bilaterale mes Shqipërisë dhe Kosovës. Nga ky moment, marrëdhëniet midis Kosovës dhe Shqipërisë konsiderohen si marrëdhënie mes dy shteteve të pavarura dhe të veçanta, të cilat qëllim parësor e kanë bashkimin nën ombrellën e BE-së. Dy ditë pas shpalljes së pavarësisë, janë vendosur marrëdhëniet zyrtare diplomatike mes dy shteteve, me çka marrëdhëniet mes dy qeverive kanë fituar një status të ri. Gati dymbëdhjetë vjet më vonë, mund të konstatohet se qeveritë në të dy anët e kufirit i konsiderojnë marrëdhëniet Kosovë - Shqipëri të një rëndësie strategjike, mbi nivelin e raporteve me çdo vend tjetër në rajon dhe më gjerë. Një gjë e tillë është demonstruar nga një varg marrëveshjesh bilaterale dhe memorandume të nënshkruara⁴⁰ midis tyre thuajse në të gjitha fushat e jetës politike, shoqërore dhe ekonomike. Janë mbajtur edhe shumë takime të niveleve të larta midis zyrtarëve përkatës, përfshirë këtu edhe takimet e përbashkëta të qeverive të të dy vendeve. Rrjedhimisht, jemi dëshmitarë të rritjes së nivelit të shkëmbimeve në lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, por edhe të bashkëpunimit të shtuar ndër-kulturor dhe mediatik.

Qëllimi i këtij seksioni nuk është të analizohet bashkëpunimi mes dy vendeve në bazë të marrëveshjeve dhe memorandumeve të nënshkruara. Në këtë seksion, do të ofrohet një vlerësim i mirëfilltë i nivelit të këtyre marrëdhënieve nga një pikëvështrim i përfaqësuesve të partive politike, akademisë dhe mediave, por edhe të vetë qytetarëve në Kosovë. Me qëllim të një trajtimi sa më gjithëpërfshirës të marrëdhënieve midis dy vendeve, është bërë një analizë e thukët e këtyre marrëdhënieve në fushat vijuese: politike dhe diplomatike, bashkëpunimit ndër-parlamentar, ekonomike, të edukimit, të kulturës, sportit, të sigurisë dhe mbrojtjes, dhe të mediave. Në bazë të intervistave, fitohet përshtypja që edhe përkundrejt marrëveshjeve, iniciativave, takimeve dhe aktiviteteve të tjera të shumta, shumica e përfaqësuesve politikë nga Kosova janë të mendimit që bashkëpunimi midis dy vendeve nga viti 2008 ka qenë më tepër formal se përmbajtësor. Madje, shumica e politikanëve të intervistuar argumentojnë që këto marrëdhënie bilaterale kanë qenë më

⁴⁰ Deri më tani, mes dy vendeve janë nënshkruar mbi 70 marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi.

tepër të karakterizuara me eufori, se me përmbajtje, domethënë, këto raporte kanë shërbyer vetëm sa për të kënaqur elementin emocional-kombëtar, por jo edhe për të mirën e dy palëve.⁴¹

Në këtë aspekt, në bazë të parametrave ekonomikë, argumentohet që bashkëpunimi është nën nivelet standarde të dy shteteve fqinje, ndërkaq që në fushat e tjera, ky bashkëpunim konsiderohet se është i pavërejtshëm dhe pa ndonjë substancë.⁴² Për më tepër, ekziston bindja se mundësitë për bashkëpunim midis dy vendeve kanë qenë shumë më të mëdha se që është bërë në realitet. Madje, duke u bazuar në historinë e përbashkët dhe në ndjenjat e qytetarëve të të dyja vendeve, edhe fuqitë e mëdha kanë pasur përshtypjen se Kosova me Shqipërinë do të kenë një bashkëpunim shumë më të madh mes veti. Në këtë aspekt, pretendohet se përfaqësuesit ndërkombëtarë kanë shpresuar se hapat integruar në të dy vendet do të jenë më të mëdhenj dhe më të shpejtë, por kjo nuk ka ndodhur për shkak të elitave të korruptuara politike në të dy anët e kufirit, që në esencë janë elita financiare dhe jo intelektuale.⁴³

Në këtë linjë të argumentimit konsiderohet që mundësitë e mëdha dhe të gjithanshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit bilateral mes dy vendeve të krijuara pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk janë shfrytëzuar sa duhet. Rrjedhimisht premtimet për një bashkëpunim më intensiv në të gjitha fushat kanë mbetur në nivel të deklaratave.⁴⁴ Poashtu, argumentohet që intensifikimi i marrëdhënieve bilaterale fillimisht nuk ka ndodhur për shkak të një presioni ndërkombëtar, meqë çdo bashkëpunim midis Kosovës dhe Shqipërisë nga bashkësia ndërkombëtare shihej si rrezik për bashkim të mundshëm. Megjithatë, konsiderohet që kjo nuk e amnistion politikën kosovare, meqë bashkëpunimi dhe integrimi janë parime evropiane, dhe elitat politike në Kosovë është dashur të angazhohen më shumë për intensifikimin e bashkëpunimit me Shqipërinë përmes projekteve konkrete në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve në të dy vendet.⁴⁵

Nga ana tjetër, pikëpamjet sipas të cilave marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës që nga shpallja e pavarësisë kanë qenë në nivel të kënaqshëm ishin të pakta. Sipas tyre, bashkëpunimi bilateral midis dy shteteve është thelluar pothuaj në të gjitha fushat, pengesat ndaj bashkëpunimit kanë qenë

⁴¹ Intervistë me Hajredin Kuçin, Nënkrjetar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe ish Zëvendës-Kryeministër i Kosovës, 27.05.2019.

⁴² Intervistë me Anton Berishën, Zëvendës Ministër i Punëve të Jashtme dhe Nënkrjetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, 30.05.2019.

⁴³ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019.

⁴⁴ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Nisma Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019.

⁴⁵ Intervistë me Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

pothuaj minimale, dhe tani është me rëndësi fakti që të dy shtetet e kanë mundësinë që vetë të vendosin se deri në çfarë shkalle dëshirojnë ta thellojnë bashkëpunimin bilateral.⁴⁶

Përfaqësuesit nga rradhët e medimeve dhe të akademisë po ashtu mendojnë që, duke i patur parasysh mundësitë ekzistuese, marrëdhëniet midis dy vendeve që nga viti 2008 kanë qenë më shumë parullë politike se realitet. Edhe pse qeveritë e të dy vendeve kanë nënshkruar marrëveshje e memorandume të shumta, në realitet është bërë fare pak që bashkëpunimi në fushat e ndryshme, prej politikës së jashtme dhe bashkëpunimit ndër-parlamentar, e deri tek fushat e ekonomisë, arsimit, kulturës dhe të sigurisë, vërtetë të jetësohet. Për më tepër, theksohet që bashkëpunimi në disa fusha është bllokuar qëllimisht për të mbrojtur interesat politike dhe ekonomike të grupeve të caktuara.⁴⁷

Po ashtu, potencohet që takimet bilaterale midis përfaqësuesve të dy vendeve më shumë kanë qenë rutinë, sa për sy e faqe, dhe me qëllim të targetimit të zgjedhësve respektivë, sesa për të lënë ndonjë memorie institucionale të bashkëpunimit. Në këtë drejtim, ky bashkëpunim nuk dallon shumë nga bashkëpunimi i Kosovës dhe ai i Shqipërisë me vendet e tjera të rajonit. Si arsye për një realitet të tillë përmendet fakti që marrëdhëniet janë ndërtuar mbi premisat e miqësive personale dhe lidhjeve të ngushta klanore dhe grupore të interesit, dhe që kanë qenë të bazuara kryesisht në përfitimet materiale personale. Si të tilla, ato nuk kanë synuar shtrirjen e këtyre marrëdhënieve më poshtë, në nivele të tjera, si dhe zgjerimin horizontal të tyre.⁴⁸

Megjithatë, fakti se falë Internetit dhe mediave sociale, shqiptarët për herë të parë kanë një hapësirë të përbashkët komunikimi mendohet të jetë një element pozitiv. Mirëpo, kjo nuk është meritë e qeverive në Tiranë e Prishtinë, por është, thjeshtë, rrjedhojë e zhvillimeve teknologjike. Për më tepër, nga aspekti i bashkëpunimit politik, realisht ekziston një shkëmbim intensiv i përvojave të “këqija”, meqë partitë politike në dy shtetet mësojnë mirë nga njëra-tjetra kur bëhet fjalë për manipulim votash, polarizim të shoqërisë dhe demontim të institucioneve të rëndësishme shtetërore.⁴⁹ Një vështrim paksa më pozitiv lidhur me marrëdhëniet Kosovë–Shqipëri thekson se përgjithësisht bëhet fjalë për raporte të mira mes dy fqinjëve që në aspektin formal nuk kanë asnjë

⁴⁶ Intervistë me Bekim Çollakun, Shef i Kabinetit të Presidentit të Kosovës dhe ish-Ministër për Integritet Evropian, Prishtinë, 12.06.2019.

⁴⁷ Intervistë me Agron Bajramin, Kryeredaktor i gazetës Koha Ditore, Prishtinë, 10.06.2019.

⁴⁸ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 10.06.2019.

⁴⁹ Intervistë me Enver Robellin, Kryeredaktor i Dialogplus, Prishtinë, 24.06.2019.

problem të hapur. Megjithatë, mbetet konstatimi që këto marrëdhënie janë të shoqëruara me shumë folklorizma dhe formalitete, por me pak përmbajtje.⁵⁰

Përfaqësuesit e partive politike konsiderojnë se bashkëpunimi bilateral në fushën politike nuk ka qenë në nivelin e duhur marrë parasysh mundësitë që janë krijuar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Në këtë aspekt, dominon mendimi që bashkëpunim të mirëfilltë politik në mes partive politike të Shqipërisë dhe Kosovës nuk ka pasur, dhe atë si mes partive në pushtet, ashtu edhe atyre në opozitë. Një lloj bashkëpunimi ka pasur në mes të krerëve të partive të ndryshme për interesa tepër të ngushta, por më shumë biznese sesa mbi baza ideologjike për interesa afatgjate politike dhe publike. Një nga arsytet për këtë qëndron në faktin se në të dy shtetet realisht mungojnë partitë politike me programe të qarta të orientimeve ideologjike. Formalisht ka parti me programe ideologjike (të majta dhe të djathta), por koalicionet e formuara viteve të fundit në Shqipëri dhe Kosovë tregojnë qartë se këto koalicione bëhen për interesa të tjera.⁵¹ Padyshim se takimet e shumta tanimë i kanë shterrur mundësitë e veta dhe duhet shkuar një hap tutje përmes krijimit të institucioneve të përbashkëta që jo vetëm do t'i implementonin marrëveshjet e arritura, por edhe do të propozonin forma të reja të bashkëpunimit. Për këtë qëllim, ngjashëm me shembujt e BE-së, Këshillit Nordik apo Benelux-it, si një mekanizëm i mundshëm sygjerohet krijimi i një Komisioni apo Këshilli Kombëtar të përbashkët, pse jo edhe të një Asambleje Parlamentare.⁵² Nga ana tjetër, të intervistuarit me qëndrime paksa më pozitive lidhur me bashkëpunimin Kosovë-Shqipëri theksojnë se mbledhjet e rregullta mes dy qeverive kanë qenë shumë të qëlluara. Megjithatë, ato ende nuk kanë prodhuar ndonjë mekanizëm institucional të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe të përditshëm mes mbledhjeve. Në këtë drejtim, iniciativa e kryeministrave Haradinaj dhe Rama për të caktuar nga një bashkërendues që përcjell zbatimin e marrëveshjeve të arritura theksohet si hap i duhur.⁵³

Të intervistuarit nga rradhët e akademisë dhe medimeve theksojnë se edhe pse marrëdhëniet në fushën politike mes dy vendeve kanë pasur një standard minimal të bashkëpunimit, ai nuk ka qenë në nivelin e duhur strategjik. Ekziston një shqetësim për trajtimin paternalist ndaj Kosovës, që shpeshherë bëhet nga përfaqësuesit politikë të Shqipërisë. Rrjedhimisht, shpesh edhe Kosova në

⁵⁰ Intervistë me Arben Hajrullahun, Profesor në Universitetin e Prishtinës, Prishtinë, 28.05.2019.

⁵¹ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019.

⁵² Intervistë me Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

⁵³ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkrjetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019.

përgjithësi, por edhe vetë qeveritarët nga Kosova, trajtohen si shtojca të Tiranës zyrtare.⁵⁴ Në këtë aspekt, konsiderohet se do të ishte më mirë sikur Shqipëria vullnetin për t'u përkujdesur për shqiptarët jashtë kufirit ta demonstronte në rastin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, dhe atë përmes ngritjes së çështjes së shqiptarëve në OSBE, Këshillin e Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare.⁵⁵

Bashkëpunimi në fushën e politikës së jashtme dhe diplomacisë po ashtu vlerësohet se nuk ka qenë në nivelin e ndonjë vizioni të përbashkët ose strategjie të harmonizuar. Njëkohësisht mungon edhe koordinimi i duhur, sepse është e pakuptimtë që në disa vende të dy shtetet të kenë ambasada, ndërsa në vendet tjera asnjëri. Njëkohësisht, mbyllja e ambasadave të Shqipërisë në Indi dhe në Bosnjë, në dy vende ku Kosova për shkak të mosnjohjes nuk mund të ketë përfaqësim diplomatik, konsiderohet se është një tregues eklatant i mungesës së koordinimit të ndërsjellë dhe mungesës elementare të bashkëpunimit strategjik në mes dy vendeve. Për më tepër, argumentohet që asnjë shtet nuk ka më pak dokumente politiko-strategjike dhe ekonomike se që kanë MPJ-të e Kosovës dhe të Shqipërisë, dhe kjo ndodh për shkak se në këtë sektor në vend të njerëzve më të mençur nga të dyja vendet, janë vendosur individë jokompetentë dhe militantë partiak.⁵⁶ Bashkëpunimi diplomatik në mes dy vendeve, argumentohet se ka qenë më shumë i fokusuar në bashkë-shfrytëzimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe të personelit në shërbimin konsullor, sesa në aspektin strategjik apo në nivel të koordinimit të përbashkët të politikës së jashtme.⁵⁷ Për një rrjet efikas diplomatik për të dyja vendet që njëkohësisht janë të ballafaquara me mungesë resurcesh,⁵⁸ konsiderohet se krijimi i hapësirave të përbashkëta për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore nuk është i mjaftueshëm, pasi kjo duhet të komplementohet me bashkëpunim në planifikimin strategjik të politikës së jashtme për të mundësuar arritjen e efekteve të synuara.⁵⁹

Nga ana tjetër, analiza e intervistave të realizuara vë në dukje se bashkëpunimi ndër-parlamentar ka qenë kryesisht i bazuar në takime dhe vizita të ndërsjella të parlamentarëve nga të dy vendet. Në masë të madhe këto kanë qenë takime sporadike mes komisioneve parlamentare të cilat kanë filluar dhe përfunduar si nisma të deputetëve individualë. Karakteri i tyre ka qenë më shumë formalo-

⁵⁴ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 10.06.2019.

⁵⁵ Intervistë me Arben Hajrullahun, Profesor në Universitetin e Prishtinës, 28.05.2019.

⁵⁶ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019.

⁵⁷ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 10.06.2019.

⁵⁸ Intervistë me Jetlir Zyberaj, Këshilltar i Ministrisë të Jashtëm të Kosovës, Prishtinë, 21.06.2019.

⁵⁹ Intervistë me Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

ceremonial, se sa karakter pune për intensifikim të bashkëpunimit, dhe nuk ka rezultuar në asnjë iniciativë të përbashkët. Ekziston mendimi se nëse asgjë tjetër, dy Parlamentet përmes komisioneve përkatëse, do të duhej ta monitoronin zbatimin e marrëveshjeve dhe vendimeve të nxjerra nga mbledhjet e dy qeverive.⁶⁰ Po ashtu theksohet se në vend të mbledhjeve të përbashkëta ceremoniale dhe marrëveshjeve të vulosura si dy palë të ndryshme, duhet krijuar mekanizma të përbashkët për realizimin e projekteve të përbashkëta, sidomos në fushat e arsimit, shkencës dhe të turizimit.⁶¹

Edhe bashkëpunimi në fushën ekonomike nuk është në nivel të kënaqshëm dhe është evidente se ekzistojnë probleme që nuk janë adresuar ende si duhet dhe që krijojnë pengesa në rritjen e shkëmbimit ekonomik dhe tregtar. Përkundrajt mundësive për krijimin e një tregu të përbashkët ekonomik kombëtar, barrierat doganore e kanë pamundësuar një gjë të tillë. Ky treg i përbashkët edhe pse është në interesin ekonomik të të dy vendeve, kryesisht nuk është arritur për shkak të mbrojtjes së interesave të oligarkisë tregtare.⁶² Në të vërtetë, ekziston përceptimi se në të dy vendet ekonomia kontrollohet nga rrjete oligarkësh të lidhur drejtpërdrejtë me pushtetin. Falë interesave të oligarkëve, shpesh Kosova ka probleme t'i eksportoje prodhimet e veta në Shqipëri, por edhe ndërmarrjet shqiptare realisht e kanë pasur të vështirë t'i plasojnë prodhimet e tyre në Kosovë.⁶³ Madje, ka zëra që pretendojnë që bashkëpunimi në fushën ekonomike ka qenë më tepër në dobi të bizneseve të Shqipërisë, meqë përmes barrierave doganore është eliminuar konkurrenca e lirë e mallrave me origjinë nga Kosova. Madje, theksohet se në shumë fusha ka më shumë barriera jo tarifore ndaj Kosovës se ndaj vendeve të tjera, me çka bizneset nga Maqedonia dhe Mali i Zi privilegjohehen më shumë se ato kosovaret.⁶⁴

Mirëpo, nga ana tjetër, argumentohet që në fushën ekonomike janë bërë hapa të rëndësishëm drejt bashkëpunimit të shtuar bilateral. Theksohet se përmirësimi i infrastrukturës rrugore e ka ngritur ndërveprimin ekonomik, ndërkaq që iniciativa e fundit drejt unifikimit doganor paraqet hap të duhur drejt njëjtësisimit të tregjeve.⁶⁵ Megjithatë, dominon mendimi se në të dy vendet janë krijuar grupe të interesit, shpesh me karakter kriminal, që vazhdimisht e kanë penguar bashkëpunimin dhe integrimin ekonomik. Prandaj, vullneti politik për t'i thyer klanet kriminale provincialiste konsiderohet si

⁶⁰ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkyetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019.

⁶¹ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019.

⁶² Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019.

⁶³ Intervistë me Enver Robellin, Kryeredaktor i Dialogplus, Prishtinë, 24.06.2019.

⁶⁴ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 10.06.2019.

⁶⁵ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkyetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019.

parakusht i domosdoshëm për rritjen e bashkëpunimit ekonomik. Ndër faktorët e tjerë që e pengojnë bashkëpunimin e shtuar ekonomik veçohet edhe mungesa e konkurrencës së shëndoshë brenda sektorëve të ndryshëm për shkak të qasjes monopoliste të ndërmarrjeve në Shqipëri. Ndërmarrjet e këtilla nuk hyjnë fare në treg po të mos jenë në pozitë dominuese, dhe prandaj nuk shohin ndonjë interes shumë të madh të bashkëpunimit me Kosovën. Nga ana tjetër, për shkak të kësaj logjike monopoliste, ndërmarrjet nga Kosova nuk gjejnë fare hapësirë në tregun e Shqipërisë, qoftë për investime, qoftë për plasim më të mirë të prodhimeve të tyre.⁶⁶

Në përgjithësi, pikëpamjet janë paksa më pozitive kur bëhet fjalë për bashkëpunimin në fushat e edukimit, kulturës, sportit dhe të mediave. Sa i përket arsimit, si element pozitiv theksohet përdorimi i Abetares, si dhe përparimi i arritur rreth këmbimit të nxënësve dhe mësimdhënësve. Megjithatë, argumentohet se meqë të dy shoqëritë kanë kaluar nëpër përvoja të ndryshme historike, bashkëpunimi në këtë fushë duhet të merr parasysh veçoritë në të dy anët e kufirit dhe të mos ketë sforcim për unifikim të çdo gjëje.⁶⁷ Po ashtu, në këtë drejtim jepen edhe vlerësime negative të cilat vënë në pah që, duke i patur parasysh mundësitë në dispozicion, bashkëpunimi në fushën e arsimit është dashur të jetë shumë më përmbajtësor. Pretendohet se në vend të rritjes së cilësisë, privatizimi i pakontrolluar që shpeshherë ishte i lidhur edhe me interesat politike ka çuar deri të rënia enorme e saj.⁶⁸ Njëkohësisht theksohet nevoja për krijimin e programeve të përbashkëta arsimore që do të mbështeteshin edhe me shkëmbime të vazhdueshme të nxënësve, studentëve dhe mësimdhënësve, jo vetëm nga Kosova në Shqipëri, por edhe anasjelltas.⁶⁹

Në fushën e kulturës, bashkëpunimi konsiderohet se ka qenë në nivel më të lartë, kryesisht meqë ekonomia e tregut e ka krijuar hapësirën e përbashkët kulturore sidomos në fushën e muzikës. Mungesa e një bashkëpunimi të tillë në fusha kulturore të pakomercializuara dëshmon qartë që ky kooperim në fushën e muzikës është meritë e tregut, dhe jo e institucioneve publike, në të dy vendet. Rrjedhimisht, ekziston nevoja për ndërhyrje më të madhe shtetërore, në mënyrë që të shtohet bashkëpunimi edhe në fushat e tjera të kulturës. Kjo sidomos vlen për produksionet filmike, por edhe për teatrin, operën, baletin dhe fusha të tjera. Njëkohësisht, shtrohet nevoja që kalendari i

⁶⁶ Intervistë me Berat Rukiqin, President i Odës Ekonomike të Kosovës, Prishtinë, 05.07.2019

⁶⁷ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkryetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019 dhe Enver Robellin, Kryeredaktor i Dialogplus, Prishtinë, 24.06.2019.

⁶⁸ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019.

⁶⁹ Intervistë me Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

përbashkët kulturor të jetë më atraktiv dhe më interaktiv duke përfshirë shtresat e gjera të popullsisë.⁷⁰

Bashkëpunimi në fushën e mediave shihet ndoshta si më i suksesshmi, meqenëse integrimi i dyanshëm ka qenë në duart e sektorit privat dhe qytetarëve, e jo në duart e politikës. Rrjedhimisht, është arritur një përparim i theksuar, sepse shtëpitë mediale nga Tirana dhe Prishtina kanë depërtuar në tregjet respektive. Për më tepër, argumentohet se mediat kanë qenë një prej fushave pioniere në përafrimin mes popujve dhe reduktimin e paragjykimëve.⁷¹ Mirëpo, gjithashtu ka zëra që mendojnë se më shumë se bashkëpunim, realisht ka pasur bashkëpërdorim të tregjeve mediatike. Madje, ka pretendime se bashkëpunimi në fushën e mediave mes dy vendeve është i ngjashëm me atë politik dhe se mafiat mediale janë pothuaj të ngjashme, si në Tiranë, si në Prishtinë. Sipas këtij vështrimi, mjafton të përcillen paksa debatet televizive për të parë se në të vërtetë ka pak debat dhe shumë tifozeri për njërin apo palën tjetër.⁷²

Bashkëpunimi në fushën e sigurisë konsiderohet se ka shënuar përparim që nga pavarësia e Kosovës, por megjithatë vlerësohet se nuk është në nivelin e mundësive. Si element pozitiv i këtij bashkëpunimi vihet në pah sidomos ai mes policisë në të dy shtetet. Në këtë drejtim, kontrolli i integruar i kufirit, patrullimi i herëpashershëm i përbashkët dhe këmbimi i ndërsjellë i informatave policore përmenden si të arritura të rëndësishme në këtë fushë. Megjithatë, shtrohet nevoja për gjetjen e formave që do ta mundësonin një integrim më të madh të këtyre mekanizmave në funksion të luftimit të krimit të organizuar.⁷³

Në fushën e mbrojtjes bashkëpunimi mes dy vendeve konsiderohet më i mangët, madje edhe në nivelin që ka ekzistuar gjatë luftës në Kosovë. Një nga arsyt kryesore që përmendet si pengesë për një bashkëpunim më intensiv është faktori ndërkombëtar. Në të vërtetë, theksohet se edhe pse në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes ka hapësirë për një bashkëpunim të shtuar, shumëçka varet nga ajo që lejohet nga mekanizmat ndërkombëtarë. Po ashtu, bashkëpunimi bëhet edhe më i vështirë kur dihet që Shqipëria është anëtare e NATO-s, ndërsa Kosova realisht ka ushtri më tepër në letër se në realitet. Marrë parasysh rëndësinë që NATO e ka për të dy vendet dhe kontrollin efektiv që kjo

⁷⁰ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkyetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019 dhe Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

⁷¹ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019, Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019 dhe Visar Ymerin, Nënkyetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019.

⁷² Intervistë me Enver Robellin, Kryeredaktor i Dialogplus, Prishtinë, 24.06.2019.

⁷³ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkyetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019 dhe Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

organizatë e ka përmbi fushën e mbrojtjes së të dyja vendeve, bashkëveprimi bilateral është i mundshëm vetëm nën ombrellën e Aleancës. Megjithatë, pjesëmarrja e forcave të armatosura të dy vendeve në ushtrimet ushtarake në territorin e njëri tjetrit konsiderohet një e arritur e rëndësishme e këtij bashkëpunimi.⁷⁴

Përveç pikëvështrimit të përfaqësuesve të partive politike, akademisë dhe mediave në Kosovë lidhur me marrëdhëniet bilaterale midis Shqipërisë dhe Kosovës, është me rëndësi të analizohet edhe pikëpamja e qytetarëve të thjeshtë të Kosovës. Duhet theksuar që pjesa më e madhe e qytetarëve në Kosovë (59%) vlerëson se zhvillimi i marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Kosovës sjell përfitime për të dy vendet. Mirëpo, shumica e qytetarëve shqiptarë në Kosovë (55.8%) megjithatë vlerëson që marrëdhëniet mes dy vendeve nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm dhe se ka ende mjaft punë për të bërë. Është interesante që 12.5% janë të mendimit se marrëdhëniet mes dy vendeve ekzistojnë thjesht në pikëpamjen formale ose, thënë ndryshe, që janë të njëjta si me çdo shtet tjetër. Për më tepër, 12% të qytetarëve në Kosovë marrëdhëniet mes dy vendeve i vlerësojnë si inekzistente, ndërkaq, ka qytetarë që theksojnë se Shqipëria është më shumë e fokusuar që të ketë bashkëpunime dhe interesa të përbashkëta me shtetet e tjera të huaja fqinje, sesa me Kosovën. Vetëm 19.7% e qytetarëve mendojnë se marrëdhëniet mes dy vendeve janë shumë të mira dhe se në këtë drejtim nuk ka asgjë për t'u përmirësuar.⁷⁵

Sa i përket fushave specifike, në përgjithësi mbizotëron mendimi se ky bashkëpunim është në nivelin e duhur vetëm në fushën e kulturës dhe sportit, ndërkaq bashkëpunimi ekonomik dhe ai në fushat e tjera konsiderohet i pamjaftueshëm. Si një nga shkaqet për mungesën e një bashkëpunimi më intensiv mes dy shteteve shpesh përmendet fakti se të dy shtetet nuk po gjejnë interesa të përbashkëta, apo se realiteti i ekonomive në të dy vendet nuk i plotëson nevojat e njëri-tjetrit.⁷⁶ Sa i përket marrëdhënieve në fushën politike, vetëm një e katërta e qytetarëve (25.1%) pajtohen plotësisht se Shqipëria bashkëpunon politikisht me institucionet e Kosovës, 24.4% pajtohen deri diku me këtë konstatim, ndërsa 22.2% kanë qëndrim neutral për këtë çështje. Për më tepër, vetëm 9.6% e qytetarëve nga Kosova vlerësojnë se marrëdhëniet në politikën e jashtme janë shumë të

⁷⁴ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019, Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019 dhe Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

⁷⁵ Agon Demi dhe Blendi Çeka, Kosovë – Shqipëri: Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi, KFOS&OSFA: Prishtinë – Tiranë, 2019, https://www.osfa.al/sites/default/files/raporti_plote_kosove_-_shqiperi_-_alb.pdf

⁷⁶ Ibid.

ngushta, edhe pse 22.2% i vlerësojnë këto marrëdhënie si të ngushta. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e qytetarëve në Kosovë (28.7%) mendojnë se bashkëpunimi në fushën e politikës së jashtme është në nivel mesatar, 11% vlerësojnë që ai është nën nivelin e duhur, ndërsa 8.8% madje mendojnë që ky bashkëpunim është inekzistent. Ngjashëm, marrëdhëniet tregtare vlerësohen si shumë të ngushta vetëm nga 14.1% e qytetarëve, si të ngushta nga 27.2%, dhe në nivel mesatar nga 30.7% e tyre. Ndërkaq, bashkëpunimi doganor konsiderohet si shumë i ngushtë nga vetëm nga 13.1%, edhe pse shumica e qytetarëve (57.5%) pajtohen plotësisht që tarifatat doganore mes dy vendeve duhen eliminuar.⁷⁷ Vlen të theksohet se sipas qytetarëve, bashkëpunimi mes dy vendeve, edhe pse me madhësi të vogël të tregut, do të ndikonte në mënyrë pozitive të drejtpërdrejtë në thithjen e investimeve të huaja direkte, dhe mbi të gjitha në cilësinë e tyre. Për vende të vogla si Shqipëria dhe Kosova, qytetarët theksojnë se krijimi i hapësirave më të mëdha të veprimit të aktivitetit ekonomik dhe financiar, gjithsesi paraqet një domosdoshmëri.⁷⁸

Ngjashëm, bashkëpunimi në fushën e arsimit konsiderohet si shumë i ngushtë nga 16% e qytetarëve, dhe pos kësaj edhe 23.5% të tjerë mendojnë se ky bashkëpunim është i ngushtë, ndërkaq 29.7% të qytetarëve vlerësojnë se ky bashkëpunim është në nivel mesatar. Duhet theksuar që shumica e qytetarëve në Kosovë (58.2%) pajtohen plotësisht me atë që kurrikula dhe tekstet shkollore në arsimin parauniversitar duhet të jenë të përbashkëta për të dy vendet, dhe vetëm 5.2% e tyre nuk pajtohen aspak me këtë. Po ashtu, edhe përkundrejt dëshirës për kamjen e një sistemi arsimor të përbashkët, apo për institucione të përbashkëta për menaxhimin dhe monitorimin e tyre, shumica e qytetarëve mendojnë se është ende e vështirë të arrihet realizimi i këtyre pritjeve.⁷⁹ Nga ana tjetër, lidhur me bashkëpunimin në fushën e sportit dhe kulturës, 48.8% e qytetarëve vlerësojnë që ai është në nivelin e duhur. Vetëm 7.6% mendojnë që bashkëpunimi në këtë fushë është nën nivel, ndërsa sipas 4.5% të qytetarëve ai është inekzistent.⁸⁰

⁷⁷ Ibid.

⁷⁸ Ibid.

⁷⁹ Ibid.

⁸⁰ Ibid.

- **Konkluzione**

Sipas pikëvështrimit të përfaqësuesve të partive politike, akademisë dhe mediave, por edhe të qytetarëve të Kosovës, mund të përfundohet se përkundër mundësive për marrëdhënie më intensive bilaterale mes dy vendeve pas pavarësisë së Kosovës, ato përgjithësisht nuk kanë qenë në nivelin e duhur. Përkundër mbledhjeve, takimeve dhe vizitave të shumta, mbizotëron mendimi se bashkëpunimi bilateral në përgjithësi ka qenë më tepër formal dhe emocional, se përmbajtësor dhe në interes të qytetarëve. Përfaqësuesit e partive politike, akademisë dhe mediave arsyen për këtë realitet kryesisht e shohin tek elitat e korruptuara dhe jokompetenete në të dy vendet. Qytetarët e Kosovës, nga ana tjetër, theksojnë se të dy shtetet nuk kanë interesa të mjaftueshme të përbashkëta dhe prandaj marrëdhëniet mes tyre janë në nivel të njëjtë si me çdo shtet tjetër. Madje, një pjesë e qytetarëve në Kosovë pretendon se Shqipëria është më shumë e fokusuar të ketë bashkëpunime dhe interesa të përbashkëta me shtetet e tjera të huaja fqinje sesa me Kosovën. Sa i përket bashkëpunimit në fushat specifike, edhe te qytetarët, por edhe te përfaqësuesit e partive politike, akademisë dhe të mediave, përgjithësisht mbizotëron mendimi se ai është nën nivelin e duhur. Ky konstatim sidomos vlen për bashkëpunimin ndër-parlamentar, politikën e jashtme, ekonominë dhe arsimin. Ekziston një perceptim i ngjashëm nga të gjithë të intervistuarit dhe qytetarët në Kosovë, se bashkëpunimi mes dy vendeve është në nivelin e duhur vetëm në fushën e kulturës, sportit dhe të mediave. Megjithatë, edhe për këto fusha mbizotëron mendimi se ka mundësi për një angazhim dhe bashkëpunim të shtuar, sidomos nga ana e institucioneve publike në të dy vendet.

III. Konsideratat e Brendshme të Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës⁸¹ në pjesën më të madhe është e ndërtuar mbi bazat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (Plani Ahtisaari)⁸², propozim ky që i përmban dispozitat vitale të saj lidhur me territorin, ndryshimet kushtetuese dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë (pakicë) në Kosovë. Prandaj, sa i përket shqyrtimit të tanishëm rreth idesë së bashkimit midis Kosovës dhe Shqipërisë është substanciale të trajtohen këto dispozita kushtetuese, duke përfshirë edhe opcionin e mbajtjes së referendumit, si dhe përceptimet publike lidhur me idenë e bashkimit.

- **Kufizimet bazike kushtetuese**

Neni 1 Paragrafi 1 i Kushtetutës Kosovën e përkufizon si “shtet të pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe të pandashëm”, ndërkaq, Paragrafi 3 i këtij neni parasheh që “Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti”⁸³. Nëse mendohet që përmes bashkimit të bëhet shuarja e shtetit të Kosovës, pra që Shqipëria ta absorbonte Kosovën, kjo do të kishte pengesa kushtetuese, meqë Kushtetuta jo vetëm që e ndalon bashkimin me një shtet tjetër, por organet kushtetuese të Kosovës nuk kanë kompetencë kushtetuese ta shuajnë shtetin e Kosovës⁸⁴.

Për më tepër, lidhur me këtë, Neni 2, Paragrafi 2 i Kushtetutës, në mënyrë shprehimore e përcakton që “Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj”⁸⁵. Kushtetuta fillon me dispozitën ku përcaktohen parimet bazë, si pandashmëria e shtetit të Kosovës, duke e përsëritur këtë atribut përsëri në Nenin e mëposhtëm (Neni 2). Ajo që është shumë e rëndësishme, posaçërisht për fqinjët, është fakti i paraparë në Paragrafin 3 të Nenit 1, i cili parasheh që Kosova nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti, meqë çdo pretendim territorial ndaj çfarëdo shteti ose pjese të tij, pos që do të ishte shkelje kushtetuese, do të krijonte jostabilitet

⁸¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës,

http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf

⁸² Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës,

<http://www.assemblyofkosovo.org/common/docs/Propozim%20per%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf>

⁸³ [Përkufizimi i Shtetit] Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

⁸⁴ Intervistë me Robert Muharrem, Profesor në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK), Prishtinë, 04.06.2019

⁸⁵ [Sovraniteti] Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

dhe tensionim në rajon e më gjerë, gjë kjo që do të paraqiste kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare⁸⁶

Atributet e këtyre Neneve (1 dhe 2) përmbajnë elemente të shumta që qartësojnë papajtueshmërinë e Kushtetutës me idenë e bashkimit, dhe në këtë drejtim, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë rezulton të jetë i pamundur në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor pse janë vendosur këto nene në Kushtetutën e Kosovës, ka qenë që të ju ikim këtyre përceptimeve për lëvizjet e mundshme në drejtim të bashkimit me Shqipëri, ndarjes apo diçka tjetër⁸⁷.

- **Kufizimet kushtetuese dhe ligjore lidhur me komunitetet jo-shumicë**

Kapitulli I (nenet 1-20)⁸⁸ i Kushtetutës përcakton dispozitat themelore të Republikës së Kosovës, disa prej të cilave kanë të bëjnë drejtpërdrejt me komunitetet, dhe këto përcaktojnë që Kosova është shoqëri shumetnike, që gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhët zyrtare të saj, ndërkohë që gjuhët boshnjake, rome dhe turke janë gjuhë zyrtare në nivel komunal⁸⁹.

Për më tepër, Neni 3.1 përcakton që “Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore⁹⁰. Këto kufizime nuk janë të patejkalueshme, por kërkojnë një punë serioze drejt akomodimit të interesave, ndjenjave dhe frikave të komuniteteve⁹¹.

Me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të interesave të komunitetit serb dhe komuniteteve tjera joshumicë në Republikën e Kosovës, atyre u është garantuar edhe përfaqësimi politik në të gjitha nivelet e pushtetit. Në këtë drejtim komuniteti serb ka të garantuar një ministër, dhe një ministër tjetër po ashtu duhet të jetë nga komunitetet e tjera joshumicë në Kosovë, ndërkaq, në rastin kur kabineti qeveritar përbëhet nga më shumë se 12 ministri, atëherë komuniteteve joshumicë në Kosovë do t’ju takojë edhe një ministër tjetër. Pra, komunitetet joshumicë e kanë të garantuar përfaqësimin në ekzekutivin e vendit me të paktën dy ministra, njëri për komunitetin serb, dhe tjetri

⁸⁶ Prof.Dr.Enver Hasani dhe Prof.Dr. Ivan Čukalović, *Komentari: Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2013, f.15.

⁸⁷ Intervistë me Hajredin Kučin, Nënkyetar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe ish Zëvendës-Kryeministër i Kosovës, Prishtinë, 27.05.2019.

⁸⁸ [Kapitulli I] Përmban dispozitat themelore ku përfshihen: Përkufizimi i shtetit, Sovraniteti, Gjuhët, Shteti Laik, Pushteti Lokal, Shtetësia etj.

⁸⁹ Dispozitat Themelore të Kushtetutës (nenet 3,5 dhe 6).

⁹⁰ [Barazia para Ligjit] Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

⁹¹ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkyetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019.

për komunitetet tjera joshumicë. Duhet theksuar që komuniteti serb dhe komunitetet tjera joshumicë i kanë të garantuar të paktën nga dy zëvendësministra, por edhe këtu, në rastin kur qeveria i ka më shumë se 12 ministri, atëherë ajo do të ketë edhe një zëvendësministër të tretë që përfaqëson komunitetin serb, si dhe një zëvendësministër tjetër që i përfaqëson komunitetet e tjera joshumicë⁹².

Komunitetet joshumicë përfaqësimin e kanë të garantuar edhe në pushtetin legjislativ, pra Kuvendin e Kosovës. Nga gjithsej 120 deputetë, komunitetet joshumicë kanë të garantuar përfaqësimin me një minimum prej 20 deputetësh, ku 10 deputetë i takojnë komunitetit serb, kurse 10 të tjerë komuniteteve tjera joshumicë⁹³. Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë është i garantuar edhe në strukturat udhëheqëse, ku dy nënkryetarë të Kuvendit, njëri nga komuniteti serb, dhe tjetri nga komunitetet e tjera, i takojnë komuniteteve joshumicë⁹⁴. Po ashtu, në kuadër të Kuvendit funksionin edhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, që është një komision i përhershëm, ku një e treta (1/3) e anëtarëve të këtij komisioni vijnë nga radhët e deputetëve që përfaqësojnë komunitetin serb, një e treta (1/3) nga komunitetet e tjera joshumicë, kurse një e treta (1/3) nga komuniteti shumicë në Kuvend⁹⁵.

Të drejtat dhe interesat e komunitetit serb në Kosovë mbrohen edhe përmes sistemit të decentralizimit dhe vetëqeverisjes lokale, në bazë të të cilit komuniteti serb ka fituar autonomi qenësore në nivelin lokal. Neni 12.1 parasheh që “Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat”, ndërkaq, Paragrafi i dytë i këtij Neni organizimin dhe funksionimin e komunave ia lë ligjit⁹⁶.

Neni 16 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale njih tri forma të kompetencave: Kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara. Kompetencat e zgjeruara, që janë të përcaktuara me Pakon e Ahtisaarit, dhe pastaj janë inkorporuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, përfshijnë disa kompetenca specifike për komunat ku komuniteti serb është shumicë. Keto komuna kanë kompetenca të zgjeruara në fusha të ndryshme si shëndetësia, edukimi, kultura, dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në emërimin e

⁹² Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve].

⁹³ Neni 64 [Struktura e Kuvendit].

⁹⁴ Neni 67.4 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve].

⁹⁵ Neni 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve].

⁹⁶ Ligji NR.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>.

komandantëve të stacioneve policore⁹⁷. Po ashtu, përmes Pakos së Ahtisaarit janë krijuar edhe pesë komuna të reja në territoret e banuara me shumicë nga komuniteti serb.⁹⁸

Pos përfaqësimit politik, komuniteteve joshumicë (pakicë) u garantohet edhe përfaqësimi në sistemin e drejtësisë, sektorin e sigurisë dhe në institucionet e tjera të pavaruara.

Duke i patur parasysh çështjet e mësipërme, në rast të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë do të shtroheshin disa çështje të rëndësishme lidhur me të drejtat e këtyre komuniteteve joshumicë. A do ti gëzonin këto të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës? Si do të përfaqësoheshin partitë politike serbe dhe të komuniteteve të tjera në një Kuvend të shtetit të përbashkët? Si do të dukeshin komunat aktuale me shumicë serbe? Cfarë do të ndodhte me këto komuna? Gjuha serbe, a do të ishte gjuhë zyrtare në nivel vendi apo vetëm në nivelin lokal? A do t'u garantohej përfaqësimi i minimumit prej 15% të gjyqtarëve në sistemin e drejtësisë? Çfarëdo lëvizje drejt bashkimit, pa trajtimin e këtyre çështjeve, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me interesat e komuniteteve joshumicë, do të kishte pasoja të paparashikuara, si për Kosovën, ashtu edhe për shtetin e përbashkët me Shqipërinë, meqë Kosova, si shtet i krijuar me përkrahjen e fuqishme të faktorit ndërkombëtar, ka dhënë garanca të forta sa i përket mbrotjes, promovimit dhe avancimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë. Çdo shmangie nga to do të mund të rrezikonte sigurinë e brendshme të shtetit të përbashkët si dhe stabilitetin dhe sigurinë rajonale.

Meqenëse Kushtetuta e Kosovës e ndalon në menyrë shprehimore çështjen e cenimit të terësisë territoriale, si dhe ka dhënë garanca të forta lidhur me mbrotjen e të drejtave të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë, këto do të paraqiteshin si pengesa të patejkalueshme në realizimin e idesë së bashkimit. Mirëpo, a do të mund të ndryshonte kjo situatë përmes ndryshimeve kushtetutese, pra, përmes amendamentimit të Kushtetutës?

⁹⁷ Neni 20 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (LVQL): Komuna e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe Shtërpçës kanë kompetenca për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve të përkujdesit shëndetësor. Neni 21 (LVQL): Komuna e Mitrovicës së Veriut ka kompetencë për shkollim të lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimorë. Neni 22 (LVQL): Të gjitha komunat, në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar përgjegjësitë për çështjet kulturore, duke përfshirë mbrotjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe religjioze serbe dhe të tjerëve, brenda territorit komunal, si dhe për mbështetjen e komuniteteve lokale religjioze, në pajtim me ligjin në zbatim. Neni 23 (LVQL): Komunat, në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantit lokal, sipas ligjit për policinë.

⁹⁸ Komunat e reja të formuara: Shtërpca, Graçanica, Parteshi, Ranillugu dhe Klllokoti.

Fillimisht, duhet nënvizuar që ideja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë do të nënkuptonte amendamentimin e pjesëve kyçe të kushtetutës. Në këtë drejtim, duhet theksuar që Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në kategorinë e kushtetutave të njohura si Kushtetuta rigjide (Rigid Constitutions)⁹⁹. Neni 144 përcakton formën dhe procedurën që duhet ndjekur për amendamentimin e Kushtetutës, ku theksohet që për ndryshimet kushtetuese (amendamentimin e saj) nevojitet miratimi i dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë edhe dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në Republikën e Kosovës: domethënë, komunitetet joshumicë kanë veton e tyre sa i përket ndryshimeve kushtetuese.

Prandaj, është plotësisht e qartë që pa ndryshimet përkatëse kushtetuese që legalisht mund të realizohen vetëm me pajtimin e komuniteteve joshumicë, nuk mund të shtrohet për diskutim, as çështja e bashkimit, dhe as forma e këtij bashkimi. Po të arrihet kjo, atëherë bashkimi mund të realizohet përmes një referendum në të dyja vendet¹⁰⁰, bazuar në ndonjë marrëveshje/traktat bashkimi të arritur paraprakisht midis Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë. Mirëpo, në këtë rast duhet qartësuar që, edhe përkundrajt faktit që arranzhmanet e tanishme kushtetuese të Kosovës bashkimin me një vend tjetër e bëjnë të pamundur, ato kurrsesi nuk e pengojnë integrimin e tyre të ndërsjellë pa bashkim politik.

Nga ana tjetër, ka argumente që në një situatë të tillë çdo vendim eventual për bashkim duhet të merret jashta Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Mirëpo, këtu shtrohet pyetja se kush do ta merrte një vendim të tillë, dhe mbi çfarë bazash ligjore e me çfarë legjitimiteti. Vendimi për bashkim jashta Kushtetutës, mendohet se mund të merret nga ajo që quhet ‘pouvoir constituant’ (constituent power – fuqia themeluese) e që është fuqia kushtetutë-dhënëse dhe e cila i paraprin asaj që quhet ‘pouvoir constitue’, d.m.th. fuqia e shprehur në kushtetutë. Pouvoir constituant është pasqyrim i forcave politike që krijojnë një rend të kushtetues të ri përmes përmbysjes së një rendi kushtetues ekzistues, p.sh. gjatë revolucioneve ose shpërthimeve nga një rend kushtetues (secesion). Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i ka cilësuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që e kanë shpallur pavarësinë e Kosovës, jo si përfaqësues të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) që kanë vepruar në kuadër të rezolutës 1244 (1999), por si pouvoir constituant, në cilësinë e përfaqësuesve politik të popullit të Kosovës. Kjo don të thotë që marrja e vendimit për bashkim

⁹⁹ Procedura e amendamentimit të kushtetutave rigjide parasheh proces më të ndërlikuar, ku nevojitet një konsensus i gjerë politik. Në rastin e Kosovës përveq konsensusit politik, nevojitet edhe miratimi i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁰⁰ Intervistë me Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

jashta Kushtetutës së Republikës së Kosovës është i mundshëm¹⁰¹, mirëpo implikimet e tij eventuale politike janë të paparashikueshme, dhe posaçërisht ato ndëretnike¹⁰².

- **Diskutim i opcionit të referendumit**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh referendumin si kategori për ushtrimin e sovranitetit të popullit: kështu, Neni 2.1 i saj përcakton që “Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute”. Sa i përket mundësisë së të qenit subjekt referendumi, Kushtetuta në mënyrë eksplicite përcakton që ligjet me interes vital nuk mund t’i nënshtrohen referendumi¹⁰³. Ndërkaq, të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve i nënshtrohen klauzolës së “interesit jetik” kështu që ato mund të ndryshohen apo shfuqizohen vetëm me përkrahjen e shumicës së përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, dhe në asnjë formë nuk do të mund jenë subjekt i referendumi.¹⁰⁴ Sa i përket organizimit dhe mbajtjes së referendumeve, fillimisht duhet theksuar që Kosova ende nuk ka ligj për referendum. Pra, (ende) nuk ka bazë ligjore për organizimin e referendumi, me përjashtim të referendumeve në nivelin lokal që janë të rregulluara me ligjin për vetëqeverisje lokale¹⁰⁵.

Ligji për Referendum është ende në proces në Kuvend, ku projektligji për referendumin është miratuar në parim me 7 nëntor 2018¹⁰⁶. Ky projektligj parasheh tre lloje të referendumeve, referendumin shfuqizues, kushtetues dhe atë konsultativ¹⁰⁷. Meqë çështja që jemi duke trajtuar ka të bëjë me ndryshimet kushtetuese do të ndalemi tek referendumi kushtetues, ku, sipas projektligjit, për iniciimin e këtij lloji të referendumi nga Kuvendi nevojiten dy të tretat e deputetëve shumicë dhe dy të tretat e deputetëve të komuniteteve të tjera, pra nevojitet miratimi i Kuvendit, duke përfshirë edhe 2/3 e deputetëve të komuniteteve joshumicë. Domethënë, këtu kemi situatë identike me atë të procedurës për amendamentimin e Kushtetutës (Neni 144). Me fjalë të tjera, ligji për referendum në

¹⁰¹ Intervistë me Robert Muharrem, Profesor në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK), 04.06.2019.

¹⁰² Interviste me Rada Trajković, ish deputete e Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 08.06.2019 dhe Miodrag Milićević, Drejtor Ekzekutiv - NGO Aktiv, Prishtinë, 25.06.2019.

¹⁰³ Neni 81 [Legjislacioni me Interes Vital]: Në legjislacionin me interes vital përfshihen këto ligje: Ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare, ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë, ligjet për përdorimin e gjuhëve etj.

¹⁰⁴ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë: Koha, 2011, f.412.

¹⁰⁵ Neni 71 [LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE].

¹⁰⁶ Telegrafi: Miratohet në parim Projektligji për referendum, 17 qershor 2018, <https://telegrafi.com/miratohet-ne-parim-projektligji-per-referendum/>

¹⁰⁷ Radio Evropa e Lirë: Tri llojet e referendumeve që do të mund të organizohen në Kosovë, 09 nëntor 2018, <https://www.evropaelire.org/a/referendimet-e-mundshme-ne-kosove/29591848.html>

asnjë formë nuk do të krijojë rrethana që do të mund ta ndryshonin Kushtetutën në ndonjë procedurë të thjeshtësuar dhe të lehtësuar, duke anashkaluar 2/3 e anëtarëve të Kuvendit që mbajnë ulëset e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë.

Një çështje tjetër e rëndësishme të cilës duhet t'i kushtohet vëmendje është ajo që ligji për referendumin, si akt juridik duhet të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën, meqë, në të kundërtën, Gjykata Kushtetuese mund ta rrëzojë si anti kushtetues, në të cilin rast ai do të shpallet i pavlefshëm. Për më tepër, Neni 113, paragrafi 3 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton që Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngritin çështjen e përputhshmërisë së referendunit të propozuar me Kushtetutën pranë Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, pyetja e cila do të shtrohej në ndonjë referendum të mundshëm duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën, meqë edhe në këtë rast Gjykata Kushtetuese referendumin mund ta shpallë si anti kushtetues. Pra, ligji për referendum, dhe, më pas, edhe vetë referendumi i propozuar, duhet të jenë në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Mirëpo, edhe përkundrejt të gjitha këtyre kufizimeve, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, bashkimin Kosovë-Shqipëri, e sheh përmes referendumeve (në të dyja vendet) apo ndryshimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga deputetët e Kuvendit.¹⁰⁸ Po ashtu, Albin Kurti, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, një parti politike kjo e cilat ndër pikat kryesore të programit politik e ka bashkimin me Shqipërinë¹⁰⁹ vazhdimisht ka deklaruar që me ardhjen/zgjedhjen e tij si Kryeministër do t'ia japë popullit të drejtën për referendum, ku ai do të vendosë lidhur me këtë çështje,¹¹⁰ mirëpo, ky opcion nuk ka hasur në përkrahje nga partitë e tjera politike në Kosovë.

¹⁰⁸ Telegrafi: Thaçi: Evropa po na poshtëron, injoron, konsideron si qytetarë të dorës së dytë – prandaj do të bashkohemi (Video) 30 maj 2019, https://telegrafi.com/thaci-evropa-po-na-poshteron-injoron-konsideron-si-qytetare-te-dores-se-dyte-prandaj-te-bashkohemi-video/?fbclid=IwAR1WTGUGS1kh3ZfEoqLeW6g_en1PqkOnu8PKNZzmH3GBINsb15NznckIniE

¹⁰⁹ Pika nr.7 e programit politik të Lëvizjes Vetëvendosje: Në vend se ta shprehë vullnetin e popullit shqiptar për bashkim kombëtar, Kushtetuta e Kosovës e mohon atë vullnet. Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron që nenit 1.1 dhe 1.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Ne angazhohemi për heqjen e nenit 1.3 që ia ndalon të drejtën Kosovës që të bashkohet me një shtet tjetër, përkatësisht me Shqipërinë. Për më tepër: https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2019/01/programi_i_shkurte1494292671-compressed.pdf

¹¹⁰ Gazeta Blic: Premtimi i Albin Kurtit nëse zgjidhet kryeministër: Kam projekt bashkimi me Shqipërinë, <https://gazetablic.com/premtimi-albin-kurtit-nese-zgjidhet-kryeminister-kam-projekt-bashkimi-shqiperine/>

- **Bashkimi Kosovë-Shqipëri në sytë e opinionit publik**

Kohëve të fundit është bërë një hulumtim i opinionit publik me qëllim që të fitohet një pasqyrë rreth pikepamjeve të qytetarëve lidhur me idenë e bashkimit kombëtar, idenë e kombit kosovar, taksën e rrugës së kombit dhe çështje të shumta të tjera lidhur me raportet midis Kosovës dhe Shqipërisë. Hulumtimi i opinionit publik është realizuar nga kompania INDEX Kosova me 1004 respondentë nga të gjitha rajonet e Kosovës, ku 392 nga ta ishin me venbanim urban, dhe 612 ishin me venbanim rural¹¹¹.

Në pyetjen “Nëse do të mbahej një referendum për bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të vetëm, si do të votonit ju personalisht?”, rezultatet tregojnë që pjesa më e madhe do të votonin pro (63.9%), ndërsa, një numër i vogël i respondentëve do të votonin kundër (16.7%). Po ashtu, është një numër i konsiderueshëm i atyre që janë përgjigjur me “Nuk di”, (18.4%) dhe kjo bën të kuptohet që kjo pjesë është ende e pavendosur rreth kesaj çështjeje. Pra, rezultatet tregojnë që ekziston dëshira për bashkim, ku, sikur të mbahej ndonjë referendum për bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë, rreth 2/3 e respondentëve do të votonin “pro”.

Mirëpo, nëse i shikojmë përgjigjet në pyetjen “Pavarësisht asaj se çfarë dëshironi ju, sa mendoni se është i mundur bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të vetëm?” (Nga 1- Aspak i mundur, e deri në 5 Plotësisht i mundur), e shohim një skepticizëm shumë të theksuar, ku 17.8% mendojnë që kjo nuk është aspak e mundur (1), kurse vetëm 8.5% mendojnë që është plotësisht i mundur (5). Pra rezultatet tregojnë që 32.9% e respondentëve mendojnë që bashkimi nuk është i mundur (1 dhe 2), kurse 17.6% mendojnë që bashkimi është i mundur (4 dhe 5). Për më tepër, pjesa më e madhe e respondentëve (36.8%) qëndrojnë në mes (3).

Sa i përket të ardhmes evropiane të Kosovës, rezultatet tregojnë që respondentët i japin më shumë prioritet anëtarësimit në Bashkimin Evropian se bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë. Në pyetjen “Cilën prej këtyre do preferonit ju, bashkimin e Shqipërisë dhe Kosovës apo anëtarësimin e Kosovës në BE?”, 66.4% janë përgjigjur që më shumë do ta preferonin anëtarësimin e Kosovës në BE.

Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e respondentëve mendon që anëtarësimi në Bashkimin Evropian do ta shuante nevojën për bashkim kombëtar. Kështu, në pyetjen “Nëse Kosova dhe

¹¹¹ Shih: Agon Demi dhe Blendi Çeka, Kosovë – Shqipëri: Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi, KFOS&OSFA: Prishtinë – Tiranë, 2019, https://www.osfa.al/sites/default/files/raporti_plote_kosove_-_shqiperi_-_alb.pdf

Shqipëria anëtarësohen në Bashkimin Evropian, a mendoni se do të shuhej nevoja për bashkim kombëtar?”, 39% e respondentëve janë përgjigjur që me rastin e anëtarësimit në BE, nevoja për bashkim do të shuhej, ndërkaq, 35.4% të tyre mendojnë që anëtarësimi në BE nuk e shuan këtë nevojë; po ashtu, 25.5% të respondentëve në këtë pyetje janë përgjigjur me “Nuk di” - pra rreth një e katërta e respondentëve nuk kanë mendimin të qartë rreth asaj se a e shuan anëtarësimi në BE nevojën për bashkim apo jo.

Kohëve të fundit ka patur diskutime të shumta rreth idesë së një marrëveshjeje midis Kosovës dhe Serbisë, sipas të cilës do të bëhej, ose ndarja e Kosovës, ose shkëmbimi i territoreve midis saj dhe Serbisë, ku Serbia do t’i merrte komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, kurse , Kosovës, në shkëmbim, do t’i bashkohej rajoni i Preshevës.

Me qëllim të identifikimit të pikëpajmeve të respondentëve rreth kësaj ideje përballë asaj të bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë, atyre u është shtruar pyetja “Sa do të pajtoheshit me marrëveshjen për ndryshimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku do të shkëmbehej veriu i Kosovës me rajonin e Preshevës, nëse si rezultat do të mundësohej bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të vetëm?” (Përgjigjet e mundshme kanë qenë nga 1 - Aspak, deri në 5 – Plotësisht.) Kjo ide është refuzuar në mënyrë kategorike, ku 74.1% janë përgjigjur që aspak nuk pajtohen me këtë ide, përballë 0.9% që do të pajtoheshin plotësisht. Pra, rezultatet tregojnë që edhe pse ekziston dëshira për bashkim, mundësia e bashkimit Kosovë - Shqipëri nuk do ta justifikonte ndarjen e Kosovës, përkatësisht, shkëmbimin e territoreve me Serbinë.

- **Konkluzione**

Mundësitë për zbatimin e çfarëdo bashkimi të Kosovës me Shqipërinë në kuadrin e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës janë pothuaj inekzistente, meqë për këtë kërkohet miratimi i komunitetit serb dhe i komuniteteve të tjera joshumicë. Po ashtu, edhe iniciimi i referendumit për bashkim nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës është pothuaj i pamundur, meqë edhe në këtë rast do të kërkohet miratimi i komunitetit serb dhe i komuniteteve të tjera joshumicë.

Ndërkaq, edhe pse vendimi për bashkim jashta Kushtetutës mund të merret nga ajo që quhet ‘pouvoir constituant’ (constituent power), e që është fuqia kushtetutë-dhënëse, implikimet politike të ndërmarrjes së një hapi të tillë ekstralegal në situatën e tanishme do të ishin të paparashikueshme, dhe atë posaçërisht sa i përket dimensionit ndër-etnik në Kosovë.

Nga ana tjetër, shumica absolute e qytetarëve të Kosovës, nëse duhet të zgjedhin midis bashkimit Kosovë-Shqipëri dhe anëtarësimit në BE, do ta preferonin anëtarësimin në BE, dhe ata po ashtu janë kundër bashkimit, nëse ky do ta kërkonte ndryshimin e kufijve apo ndarjen e Kosovës.

IV. Konsideratat Ndërkombëtare të Kosovës

Vetëdija e “popujve” apo “kombeve” për të (ri)konstituuar entitete të veçanta politiko-juridike ka qenë gjithmonë faktor thelbësor në marrëdhëniet ndërkombëtare. Rëndësia e këtij parametri gjeopolitik është rritur ndjeshëm që nga shekulli XIX dhe në pjesën e parë të shekullit XX,¹¹² dhe ka vazhduar të shpërfaqet deri në ditët e sotme. Megjithatë, transformimi i afiniteteve etnike dhe kulturore në një organizim të vetëm territorial nuk është, as i lehtë, dhe as i thjeshtë, ashtu siç edhe është dëshmuar me rastin e krijimit dhe shpërbërjes së shteteve në Ballkan gjatë dy shekujve të fundit. Në këtë aspekt, populli shqiptar në raport me popujt e tjerë të Ballkanit nuk është përjashtim nga ky fenomen, që filloi me lëvizjen për krijimin dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë (1908-12), dhe arriti pikën e vet kulmore me shpalljen e pavarësisë së Kosovës (2008), e cila edhe shënoi përfundimin e procesit pothuaj 20 vjeçar të shpërbërjes së Jugosllavisë.

Në këtë aspekt e Drejta Ndërkombëtare nuk i njeh “popujt e ndarë” si kategori të veçantë juridike, përderisa edhe vet koncepti i “shteteve të ndara” vështrohet si i padobishëm në aspektin juridik, përkundrajt faktit që ato nganjëherë mund të trajtohen si një shtet i ndarë në entitete të ndryshme. Megjithatë, në raport me të Drejtën Ndërkombëtare, rastet e tilla ju referohen kritereve të përgjithshme të shtetësisë dhe suksedimit, dhe jo ndonjë kategorie të veçantë juridike¹¹³. Rrjedhimisht, në aspektin ligjor ndërkombëtar, Kosova dhe Shqipëria nuk mund të trajtohen me narrativën e shteteve të ndara, ashtu siç ishte rasti i dy Gjermanive apo ai i Kinës, Vietnamit dhe dy Koreve, pas Luftës së Dytë Botërore, meqë ato asnjëherë nuk kanë qenë një shtet i përbashkët.

Për këtë arsye, dekonstruktimi i idesë së bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë, mund të trajtohet në mënyrë korrekte përmes prizmit të së drejtës dhe politikës ndërkombëtare të bashkimit të dy shteteve sovrane. Për më tepër, në këtë rast specifik, Shqipëria gëzon legjitimitet të plotë ndërkombëtar, ndërkohë që Kosova përballet me sfidën e legjitimitetit të cunguar dhe integritetit të pjesshëm në organizatat ndërkombëtare, gjë kjo që trajtimin e këtij dekonstruktimi e bën edhe më të ngatërruar.

¹¹² James R. Crawford, *The Creation of States in International Law*, Second Edition, Oxford: Clarendon Press, 2007, f.449.

¹¹³ Ibid, f.477.

- **Modalitetet e bashkimit dhe asocimit të shteteve të pavarura dhe sovrane**

Në analogji me procesin e krijimit të shteteve të reja, edhe për sa i përket bashkimit të dy shteteve të pavarura, e Drejta Ndërkombëtare, përgjithësisht, hesht – përveç kur kjo i prek normat jus cogens, apo ndonjë detyrim specifik ndërkombëtar (për shembull, nëse ka ndonjë marrëveshje/traktat të veçantë ndërkombëtar që i referohet një situatë të veçantë). Mirëpo, në shumicën e rasteve, bashkimi i shteteve të pavarura dhe sovrane në aspektin e të Drejtës Ndërkombëtare trajtohet përmes suksedimit të shteteve, që nënkupton zëvendësimin e një shteti me shtetin tjetër për sa i përket përgjegjësisë për territorin në fjalë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Megjithatë, çështja e suksedimit në të Drejtën Ndërkombëtare mbetet një çështje e ndërlikuar që nuk është e rregulluar në tërësi. Në këtë aspekt, shumë praktika të suksedimit janë zhvilluar si pasojë e përgjigjeve ndaj ndryshimeve dhe situatave të veçanta politike, e që, në anën tjetër, nuk janë trajtuar në mënyrë konsistente nga bashkësia ndërkombëtare.¹¹⁴ Në masë të madhe, aspektet ndërkombëtare të suksedimit në ditët e sotme janë të rregulluara nga Konventa e Vjenës për suksedimin e shteteve lidhur me traktatet (1978)¹¹⁵ dhe Konventa e Vjenës për suksedimin e shteteve lidhur me pronën shtetërore, arkivat dhe borxhet (e cila ende nuk ka hyrë në fuqi)¹¹⁶, të cilat e pasqyrojnë të Drejtën Ndërkombëtare të tanishme.¹¹⁷

Në anën tjetër, në bazë të së Drejtës Ndërkombëtare, janë dy metoda të bashkimit të dy shteteve të pavarura dhe sovrane, dhe atë shkrirja e tyre në një shtet në tërësi të ri (çfarë është rasti i bashkimit të Republikës Arabe të Jemenit me Republikën Demokratike të Jemenit në Republikën e Jemenit), si dhe absorbimi vullnetar i një shteti nga shteti tjetër, me ç'rast shteti i absorbuar pushon së ekzistuari, ndërsa ai absorbues vazhdon kontinuitetin e tij shtetëror me një territor dhe popullatë të zgjeruar (rasti i dy Gjermanive)¹¹⁸.

Forma të tjera të integritit të shteteve, por jo edhe të bashkimit politik të tyre, janë shtetet e asocuara që e kanë subjektivitetin e tyre ndërkombëtar si shtete të pavarura, por të cilat për shkak të

¹¹⁴ Malcom N. Shaw, *International Law*, Sixth Edition, Cambridge: Cambridge University Press 2008, f.958.

¹¹⁵ Vienna Convention on Succession of States in Respect of Treaties, Vienna, 23 August 1978. Entered into force on 6 November 1996. United Nations, Treaty Series, vol. 1946, http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/3_2_1978.pdf

¹¹⁶ Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts, Vienna, 8 April 1983. (Nuk ka hyrë ende në fuqi), http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/3_3_1983.pdf

¹¹⁷ Malcom N. Shaw, *International Law*, Sixth Edition, Cambridge: Cambridge University Press 2008, f. 963 – 964.

¹¹⁸ Shih: James R. Crawford, *The Creation of States in International Law*, Second Edition, Oxford: Clarendon Press, 2007, f.705.

vogëlsisë së tyre dhe resurseve të limituara njerëzore kanë marrëdhënie të veçanta me një shtet më të madh që zakonisht e merr rolin e protektorit (çfarë janë rastet e asocimit të Lichtenstainit me Zvicrën, Monakos me Francën apo San Marinos me Italinë), si dhe Komonuelti, që është një formë tjetër e asociacionit të shteteve të pavarura që mbledh vende sovraane duke u bazuar në interesat e përbashkëta dhe lidhjet e tyre historike, dhe këto edhe mund të kenë personalitet juridik ndërkombëtar. Ndërkaq, forma më e avancuar e shteteve të asocuara është Bashkimi Evropian, i cili ka personalitet juridik ndërkombëtar si organizatë rajonale, që ligjet e veta ua imponon vendeve anëtare, dhe ka kompetenca në negocimin e marrëveshjeve me palët e treta dhe të përfaqësimit në ato vende përmes delegacioneve, si dhe të drejtën për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare¹¹⁹.

Mirëpo, sa i përket suksesimit të shteteve që janë bashkuar (të shkruara apo të zgjeruara përmes absorbimit të një shteti nga një tjetër), anëtarësimi dhe marrëdhëniet e tyre kontraktuale në organizatat ndërkombëtare varen prej normave dhe rregullativave ligjore të organizatave respektive. Ndërkaq, meqenëse vendet anëtare të asociacionit të shteteve kanë personalitet të veçantë juridik ndërkombëtar dhe anëtarësi të veçantë në organizatat ndërkombëtare, dispozitat juridike të suksesimit me rastin e asocimit të tyre me njëri-tjetrin rrjedhimisht nuk janë të aplikueshme.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më sipër, dekonstruktimin e idesë së bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë do ta trajtojmë përmes opsioneve të absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, shkrirjes së Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të ri dhe asocimit të tyre me njëra tjetrën si shtete të pavarura. Kjo e tëra do të bëhet nga këndvështrimi i opsioneve të bashkimit në raport me konsideratat dhe implikimet e (mos)anëtarësisë në Kombet e Bashkuara, në NATO, dhe procesin e integritetit dhe anëtarësimin të të dyja vendeve në Bashkimin Evropian.

- **Opcionet e bashkimit dhe të asocimit në raport me Kombet e Bashkuara**

Korniza juridike e Kombeve Bashkuara, për sa i përket suksesimit të anëtarësisë në rastin e krijimit të një shteti i ri përmes shkrirjes së dy shteteve anëtare, parasheh zëvendësimin e anëtarësisë së shteteve paraardhëse në këtë organizatë me shtetin e ri, ndërsa në rastin e absorbimit vullnetar të një shteti nga një shtet tjetër, anëtarësia e shtetit të absorbuar në këtë organizatë pushon së ekzistuari.¹²⁰

Rrjedhimisht, në rastin e opsionit të bashkimit përmes absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, anëtarësia e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara do të vazhdojë, mirëpo legaliteti i absorbimit të

¹¹⁹ Malcolm R. Shaw, *International Law*, Sixth Edition, Cambridge: Cambridge University Press 2008, f.238-242.

¹²⁰ Ibid.

Kosovës mund të kontestohet nga një numër i paparashikuar i vendeve anëtare të OKB-së, meqë Kosova në momentin e tanishëm nuk është anëtare e kësaj organizate pasi që shtetësia e saj nuk gëzon legjitimitet të plotë ndërkombëtar.

Për më tepër, nëse Prishtina dhe Tirana e ndërmarrin një hap të tillë pa përkrahjen paraprake të vendeve perëndimore anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka shumë gjasa që ky akt do të trajtohet prej këtij organi të KB, dhe që do të mund të ndërmerren masa të rënda, si ndaj Shqipërisë, ashtu edhe ndaj Kosovës, përfshirë këtu edhe rifuqizimin e plotë të dispozitave të Rezolutës 1244 (1999) si dhe vendosjen e sanksioneve ndaj Shqipërisë. Për më tepër, edhe nëse masat ndaj një akti të tillë bllokohen nga ndonjëri prej anëtarëve të përheshëm të OKB-së, ato mund të procedohen nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, dhe kjo mund të sjellë pasoja të paparashikuara për të dyja vendet, pavarësisht faktit që kjo gjykatë nxjerr vetëm opinionë këshilldhënëse.

Nuk ka dyshim që ndërmarrja e këtij hapi do t'ia jipte një goditje të pariparueshme shtetësisë së Kosovës, dhe kjo sovranitetin e saj mbi territorin e vet do ta katandiste në çështje pazari midis Tiranës dhe Beogradit, ku Prishtina do të eliminohej si palë negociuese, meqë, praktikisht, nuk do të ekzistojë si shtet edhe më tutje. Në këtë situatë Serbia, dhe jo vetëm ajo, mund të kontestoj absorbimin e Kosovës nga Shqipëria me argumentin se Rezoluta 1244 (1999) e konsideron Kosovën si pjesë të Serbisë, dhe se sipas Nenit 25 dhe atij 103 të Kartës së Kombeve të Bashkuara¹²¹ Shqipëria duhet t'i jep përparësi Rezolutës 1244 (1999). Në anën tjetër, Shqipëria mund të përdor si argument Mendimin Këshilldhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, gjegjësisht pikën 113 në bazë të së cilës zgjidhja politike e statusit të Kosovës është jashtë fushëveprimit të Rezolutës 1244 (1999). Duke pasur parasysh konstelacionin e tanishëm ndërkombëtar rreth pavarësisë së Kosovës, një skenar i tillë do të ishte ideal për kënaqjen e apetiteve territoriale të Serbisë ndaj Kosovës, të cilat në një situatë të tillë nuk do të ndaleshin vetëm në veriun e vendit, por do të shtriheshin edhe në pjesët e tjera të banuara nga komuniteti serb.

Nga ana tjetër, në rast të anëtarësimit të Kosovës në Kombet e Bashkuara, realizimi i çfarëdo opsioni të bashkimit midis Prishtinës dhe Tiranës, nuk do të duhej të kishte pasoja nga kjo organizatë, pos në rastin e zëvendësimit të Rezolutës 1244 (1999) me ndonjë rezolutë tjetër të Këshillit të Sigurimit, me të cilën Kosovës do t'i ndalohej në mënyrë shprehimore bashkimi me vendet e tjera apo me pjesë të

¹²¹ Karta e Kombeve të Bashkuara, San Francisco, 1945, <https://treaties.un.org/doc/publication/ctc/uncharter.pdf>

territoreve të tyre. Në skenarin e fundit, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, qoftë përmes shkrirjes, qoftë përmes absorbimit, do të paraqiste thyerje të qartë të së Drejtës Ndërkombëtar, me ç'rast që të dyja vendet do të mund të sanksionoheshin për ndërmarrjen e një akti të tillë, dhe në fund do të detyroheshin ta zhbëjnë bashkimin e tyre.

Ndërkaq, opsioni i asocimit të Kosovës dhe Shqipërisë, i cili do të përfshinte modalitetet e bashkëpunimit dhe integritetit midis dy vendeve deri në nivelin e krijimit të një personaliteti të ri juridik ndërkombëtar, nuk mund të pritet të shkaktojë reagim nga Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Kombeve të Bashkuara, meqë ky opsion nuk do të nënkuptonte në asnjë formë delegimin e ndonjë pjese të sovranitetit të Prishtinës tek Të Tirana, apo sovranitetin e përbashkët të dy vendeve në territorin e njëri tjetrit.

Mirëpo, nëse asocimi midis Prishtinës dhe Tiranës arrin nivelin e krijimit të një personaliteti të ri juridik ndërkombëtar, ndërkohë që Kosova nuk e gëzon statusin e anëtarit të Kombeve të Bashkuara, kjo mund të shkaktojë reagim nga vende të caktuara të Këshillit të Sigurimit, si dhe të atyre në Asamblesë Gjenerale, të cilat mund ta kontestojnë legalitetin e këtij asocimi, në rastin më ekstrem përmes procedimit të tij në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për të interpretuar “traktatin e asocimit” në raport me shkeljet eventuale të së Drejtës Ndërkombëtare.¹²²

- **Opsionet e bashkimit dhe asocimit në raport me NATO-n**

Për dallim nga Kombet e Bashkuara, që suksesimin e anëtarësimit përmes bashkimit të dy shteteve në këtë organizatë e kanë të rregulluar, Traktati Veri – Atlantik këtë çështje nuk e rregullon në mënyrë taksative¹²³. Për më tepër, anëtarësimi në NATO nuk është i limituar vetëm në vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara¹²⁴. Nga ana tjetër, rasti i parë dhe i vetëm deri më tani i bashkimit të ndonjë vendi të NATO-s me një vend tjetër, që për më tepër nuk ishte anëtar i kësaj organizate, ishte ai i absorbimit të Republikës Demokratike të Gjermanisë nga Republika Federale e Gjermanisë, në tetor të vitit 1990, i cili në literaturën akademike është trajtuar gjerësisht¹²⁵.

¹²² Statuti i Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë, Neni 36, <https://www.icj-cij.org/en/statute>

¹²³ Shih: North Atlantic Treaty, Washington D.C., 4 prill 1949,

https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/stock_publications/20120822_nato_treaty_en_light_2009.pdf

¹²⁴ Italia dhe Portugalia, si vende themeluese të NATO-s, nuk ishin anëtare të KB deri në fund të vitit 1955, ndërsa Gjermania Perëndimore që NATO-s iu bashkua në vitin 1954, nuk ishte anëtare e KB deri në vitin 1973.

¹²⁵ Shih, për shembull, Stefan Oeter, German Unification and State Succession, Heidelberg Journal of International Law, Heidelberg: Max Planck Institute for Comparative Public Law and International Law, 1991; Frans G. von der Dunk and Peter H. Kooijmans, The Unification of Germany and International Law, Michigan Journal of International Law,

Bashkimi gjerman, që u realizua përmes zbatimit të Traktatit të Bashkimit midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës Demokratike të Gjermanisë të 31 gushtit 1990¹²⁶, ishte rezultat i rrethanave të jashtëzakonshme që u shfaqën në Evropë me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe konsensusit të Autoritetit të Katër Fuqive (Bashkimit Sovietik, Britanisë së Madhe, Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës) për ta lejuar dhe përkrahur absorbimin e Republikës Demokratike të Gjermanisë nga Republika Federale e Gjermanisë, duke përfshirë këtu edhe anëtarësinë e këtij shteti të zgjeruar në NATO¹²⁷.

Ky rast krijoi edhe një precedent të rëndësishëm, atë të bashkimit të një vendi anëtar të NATO-s, me një vend tjetër që nuk është anëtar i kësaj aleance. Në aspektin legal, vendet anëtare të NATO-s paraprakisht i dhanë përkrahje bashkimit të dy Gjermanive, dhe atë në takimin e Këshillit Veri-Atlantik në nivel të ministrave të jashtëm të 7–8 qershorit të vitit 1990, ku ata morrën vendim që garancat e sigurisë të specifikuara nga Nenet 5 dhe 6 të Traktatit Veri-Atlantik do të shtrihen në të tërë territorin e Gjermanisë së bashkuar¹²⁸.

Në parim, Shqipëria si anëtare e NATO-s, dhe Kosova si një vend që nuk është anëtar i saj, duke u bazuar në precedentin e bashkimit gjerman, teorikisht do të mund të bashkoheshin përmes absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, nëse një opsion i tillë do ta fitonte përkrahjen paraprake të të gjitha vendeve anëtare të NATO-s për shtrirjen e garancave të Neneve 5 dhe 6 të Traktatit Veri-Atlantik në të tërë territorin e këtij shteti të zgjeruar. Për më tepër, fakti që Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara nuk do të shkaktojte ndonjë problem për NATO-n për sa i përket shtrirjes së garancave të saj të sigurisë në territorin e Kosovës.

Megjithatë, realizimi i këtij skenari në situatën e tanishme është pothuaj i pamundur, për shkak të mos-njohjes dhe kontestimit të pavarësisë së Kosovës nga katër vende të NATO-s (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja), si dhe nga Serbia që atë vazhdon ta konsiderojë si pjesë të veten. Mirëpo, edhe nëse këto çështje do të zgjidheshin në ndonjë të ardhme, është vështirë të imagjinohet

Michigan: Spring 1991; dhe Michael Cox and Steven Hurst, “His finest hour: George Bush and the Diplomacy of German Unification”, *Diplomacy & Statecraft*, London: Frank Cass, Vol. 13, No. 4, December 2002.

¹²⁶ The Unification Treaty between the FRG and the GDR (Berlin, 31 August 1990), signed by Wolfgang Schäuble, Interior Minister of the Federal Republic of Germany (FRG), and Günther Krause, Junior Minister to Lothar de Maizière, Prime Minister of the German Democratic Republic (GDR)

https://www.cvce.eu/content/publication/1997/10/13/2c391661-db4e-42e5-84f7-bd86108c0b9c/publishable_en.pdf

¹²⁷ Për hulumtim të mëtejshëm shih: Michael Cox and Steven Hurst, “His finest hour: George Bush and the Diplomacy of German Unification”, *Diplomacy & Statecraft*, London: Frank Cass, Vol. 13, No. 4 December 2002.

¹²⁸ Final Communiqué: Meeting of the North Atlantic Council at the Level of Foreign Ministers, 7-8 June 1990, point 15, https://www.nato.int/cps/su/natohq/official_texts_23696.htm?selectedLocale=en

që vendet kyçe të NATO-s, por edhe vendet anëtare të rajonit, do të pajtoheshin me bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë, dhe jo vetëm për shkak të balanceve në rajon, por po ashtu edhe për shkak të mundësisë së shfaqjes së rasteve të reja të të njëjtës natyrë, çfarë do të mund të ishte, për shembull, bashkimi i Moldavisë me Rumaninë¹²⁹.

Një çështje që duhet shtruar këtu është ajo se çfarë pasojash do të mund të kishte ndërmarrja e ndonjë akti të njëanshëm të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, qoftë përmes absorbimit, qoftë edhe përmes shkrires së tyre në një shtet të ri, në situatën e tanishme kur shtetësia e Kosovës është e kontestuar nga katër vende të NATO-s. Nëse Kosova përmes një akti të tillë do të absorbohej nga Shqipëria, ajo do ta humbiste shtetësinë e vet dhe njëkohësisht territori i saj nuk do të mbulohej nga garancat e sigurisë së NATO-s që i jepen vendeve anëtare. Për më tepër, nëse një akt i tillë do të ndërmerrej në kundërshtim me SHBA-të, Francën dhe Britaninë e Madhe, si pasojë do të mund të ishte ri-fuqizimi i Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke nënkuptuar rikthimin e mundshëm të autoritetit të plotë të UNMIK-ut (Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), suspendimin e autoriteve nacionale dhe fuqizimin e komponentës së zbatimit të paqës nga ana e KFOR-it, që në terma praktikë shtetësinë e Kosovës do ta kthente në pikën zero, domethënë në qershorin e vitit 1999.

Në anën tjetër, edhe përkundrejt faktit që NATO-ja nuk ka dispozita ligjore për suspendimin e anëtarëve të vet¹³⁰, vendet anëtare të saj, në këtë rast, bazuar në Nenin 60 të Konventës së Vjenës e Ligjit për Traktatet (1960)¹³¹ mund të deklarojnë që Shqipëria ka bërë “shkelje materiale” të Traktatit Veri-Atlantik, dhe ta suspendojnë apo ndërpresin anëtarësinë e saj në Aleancën Veri-Atlantike.¹³² Një skenar i tillë do të ishte fatal për Shqipërinë (dhe për të gjithë shqiptarët në rajon), meqë ajo do të humbte anëtarësinë në NATO dhe do të konsiderohej nga bota perëndimore si shtet matrapaz, “rogue state,” pra, një vend që e rrezikon sigurinë dhe rendin ndërkombëtar.

¹²⁹ Shih, për shembull, Romanian Parliament says would back Reunification with Moldova, Reuters, March, 27th, 2018 <https://www.reuters.com/article/us-romania-moldova/romanian-parliament-says-would-back-reunification-with-moldova-idUSKBN1H32CS>. Moldavia iu bashkua Mbretërisë së atëhershme rumune në vitin 1918, mirëpo ajo u aneksua nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1940.

¹³⁰ Shih për shembull: Can NATO Members Kick Turkey Out of the Military Alliance?, Haaretz, October 16, 2019, <https://www.haaretz.com/middle-east-news/turkey/can-nato-members-kick-turkey-out-of-the-military-alliance-1.7993968>

¹³¹ Vienna Convention on the Law of Treaties, Vienna, 23 May 1969, Entered to force on 27 January 1980, http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969.pdf

¹³² Shih, për shembull, analizën për suspendimin apo ndërprerjen e anëtarësisë së Turqisë në NATO: Aurel Sari, Can Turkey be Expelled from NATO? It's Legally Possible, Whether or Not Politically Prudent, Just Security, New York: Reiss Center of Law, New York University School of Law, October 15, 2019, <https://www.justsecurity.org/66574/can-turkey-be-expelled-from-nato/>

Në rrethanat e tanishme, sikur Kosova dhe Shqipëria do të vendosnin që përmes një akti të njëanshëm të shkrihen dhe ta krijojnë një shtet të ri, pasojat do të ishin përafërsisht të njëjta si edhe në rastin e mësipërm të absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, por me një dallim të vogël: në këtë rast, çështja e kontinuitetit të anëtarësisë së Shqipërisë në NATO do të ishte çështje e vendimit politik të vendeve anëtare të Aleancës Atlantike, të cilat në këtë rast fare lehtë mund të konstatojnë se meqenëse Shqipëria ka pushuar së ekzistuari si shtet, me këtë pushon edhe anëtarësia e saj në NATO.

Në rastin kur Kosova do të njihej nga të gjitha vendet e NATO-s, gjë kjo që mund të pritet pas njohjes së saj nga Serbia, në gjendjen kur Shqipëria është anëtare e NATO-s, ndërkaq, Kosova nuk e gëzon këtë status, ndonjë ndërmarrje e hapave të njëanshëm drejt bashkimit të të dyja formave mund të ketë implikime të ngjashme me skenaret e mësipërme, me dallimin që Kosova do ta humbte në mënyrë vullnetare shtetësinë e vet, përfshirë këtu edhe anëtarësinë e mundshme në Kombet e Bashkuara, ndërkaq, Shqipëria do ta rrezikonte suspendimin dhe ndërprerjen e anëtarësisë së saj në NATO. Kjo do të kishte pasoja të paparashikuara për të dyja vendet, që vështirë se do të mund të rikuperoheshin për një kohë të gjatë.

Një skenar interesant që duhet të trajtohet është edhe opsioni i bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë, në një situatë kur të dyja vendet do të ishin anëtare të NATO-s, pa miratimin paraprak të të gjitha vendeve të tjera të Aleancës Veri-Atlantike. Në rast të opsionit të absorbimit, edhe përkundrajt faktit që territori i Kosovës deri në atë moment do t'i gëzonte garancat e sigurisë së NATO-s, ato do të mund të humbeshin, pasi që me këtë akt Kosova, me pushimin e ekzistencës së saj si shtet, edhe de fakto, edhe dhe de jure, do të vetë-përrjashtohej nga Aleanca Veri-Atlantike. Përpos zhbërjes së Kosovës si shtet, një opsion i tillë do të mund të çonte edhe në suspendimin apo ndërprerjen e anëtarësisë së Shqipërisë në NATO, dhe këto do të kishin pasoja të paparashikuara për të dyja vendet.

Me opsionin e bashkimit të njëanshëm përmes shkrires së Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të ri, varësisht nga interpretimi politik i vendeve të tjera të NATO-s, që të dyja vendet do të mund të përballëshin me vetëpërrjashtimin e tyre nga Aleanca, meqë fare lehtë do të mund të mbizotëronte interpretimi se që të dyja vendet kanë pushuar së ekzistuari, dhe se nëse shteti i ri dëshiron të bëhet anëtar i NATO-s, ai duhet të ri-aplikojë për anëtarësim në këtë organizatë.

Për sa i përket opsionit të asociacionit të butë midis Kosovës dhe Shqipërisë, për aq sa ai nuk krijon një person të ri juridik ndërkombëtar, dhe nuk i cenon politikat e mbrojtjes dhe të sigurisë së NATO-s, nuk do të mund të pritet që të shkaktojë ndonjë problem me vendet anëtare të saj. Mirëpo, nëse ky asocim bëhet në mënyrë unilaterale dhe e përfshin edhe komponentën e vetë-mbrojtjes bilaterale, kjo mund të shkaktojë probleme me vendet e NATO-s, dhe posaçërisht në rastin kur Kosova nuk është anëtare e Aleancës Veri-Atlantike. Kjo do të mund të interpretohej si keqpërdorim i garancave të sigurisë së NATO-s nga Shqipëria në njëren anë, dhe, në anën tjetër, një akt i tillë do të mund të çonte në pezullimin apo edhe ndërprerjen e procesit të integritit të Kosovës në NATO.

Në rast të anëtarësimit edhe të Kosovës në NATO, asocimi i të dyja vendeve i cili do të përfshinte edhe komponentën e mbrojtjes, do të ishte plotësisht i panevojshëm, meqë dy vendet do të ishin edhe formalisht aleate, dhe, në anën tjetër, edhe vetë Neni 3 i Traktatit Veri-Atlantik e inkurajon bashkëpunimin midis anëtarëve të tij në zhvillimin e kapaciteteve të tyre të mbrojtjes individuale dhe kolektive për t'i rezistuar sulmeve të armatosura¹³³.

- **Opsionet e bashkimit dhe asocimit në raport me Bashkimin Evropian**

Derisa në analizën e mësipërme si rast i referencës është përdorur bashkimi gjerman, në raport me Bashkimin Evropian ky rast nuk mund t'i referohet bashkimit apo asocimit të Kosovës dhe Shqipërisë, pasi bashkimi i dy Gjermanive (1990) është realizuar para se të themelohej Bashkimi Evropian me Traktatin e Maastrichtit (shkurt 1992) dhe marrëveshjen për Kriteret e Kopenhagës (qershor 1993) për vendet candidate për anëtarësim në BE, si dhe para evoluimit të mëtutjeshëm të BE-së përmes Traktateve të Amsterdimit (1997), Nicës (2001) dhe të Lisbonës (2007).

Prandaj, analizën e mëtutjeshme të opsioneve të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, dhe atë përmes ndërmarrjes së hapave unilaterale dhe pa arritjen e pajtueshmërisë paraprake me të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, do ta trajtojmë përmes thjerrëzave legale të Traktatit të Lisbonës.¹³⁴

Shqipëria e ka nënshkruar Marrëveshjen për Asocim-Stabilizim me Bashkimin Evropian, në qershor 2006, ndërkaq, statusi i kandidatit për anëtarësim në BE i është dhënë në qershor 2014, dhe më 29

¹³³ Shih: Neni 3. Traktati Veri – Atlantik; North Atlantic Treaty, Washington D.C., 4 prill 1949, https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/stock_publications/20120822_nato_treaty_en_light_2009.pdf

¹³⁴ Shih tekstin e konsoliduar të Traktateve të Bashkimit Evropian të amandamentuara nga Traktati i Lisbonës, https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/228848/7310.pdf

maj 2019 Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e bisedimeve për anëtarësim,¹³⁵ mirëpo kjo nuk e mori dritën e gjelbër të Këshillit Evropian më 18 tetor 2019.¹³⁶ Nga ana tjetër, Kosova e ka nënshkruar vetëm Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim me BE-në, më 27 tetor 2019¹³⁷, dhe ajo nuk është e njohur nga pesë vende të BE-së (Greqia, Qiproja, Rumania, Sllovakia dhe Spanja).

Në një kësi situatë, madje edhe nëse në një të ardhme të afërt BE-ja do t'i hapte negociatat për aksesion me Shqipërinë, ndërmarrja e çfarëdo hapave të njëanshëm drejt bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë do të mund të shkaktonte pasoja të rënda për të ardhmen evropiane të të dy vendeve. Me opsionin e bashkimit përmes absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, automatikisht do të zhbëhej Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim midis BE-së dhe Kosovës, meqë Kosova do të pushonte të ekzistonte si shtet, dhe, nga ana tjetër, do të ndërpritej apo bllokohej nga BE-ja edhe procesi i negociatave për anëtarësim me Shqipërinë, përfshirë këtu edhe suspendimin e Marrëveshjes për Asocim-Stabilizim midis BE-së dhe Shqipërisë. Në rast të opsionit të bashkimit përmes shkrirjes së Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të ri, në BE do të mund të mbizotëronte interpretimi që ky shtet i ri nuk mund t'i trashëgojë statutet e mëparshme kontraktuale dhe integruese me BE-në, gjë që efektivisht do ta kthente situatën për të dyja vendet në raport me BE-në vitin 1999, por me dallimin që prej vendeve aleate të Perëndimit, ato do të shndërroheshin në vend matrapaze dhe të izoluara nga bota demokratike.

Në situatën kur të dyja vendet do të ishin anëtare të BE-së, dhe në mënyrë të njëanshme do ta bënin bashkimin a tyre përmes absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, Kosova në mënyrë automatike do ta humbiste shtetësinë dhe “regjimin evropian” në territorin e saj, përfshirë këtu edhe shtetësinë evropiane të qytetarëve të saj. Nga ana tjetër, anëtarësia e Shqipërisë në BE, në rastin më të mirë, do të mund të suspendohej me vendim të shumicës së kualifikuar të vendeve anëtare¹³⁸, ndërkaq, në rastin më ekstrem, ajo do të mund të përjashtohej nga BE-ja nëse kjo çështje interpretohej në bazë të Nenit 60 të Konventës së Vjenës të Ligjit për Traktatet (1960),¹³⁹ duke konsideruar që Shqipëria në këtë rast ka bërë “shkelje materiale” të Traktatit të Bashkimit Evropian. Në rast të bashkimit të

¹³⁵Shih: EC: Albania and North Macedonia to open the negotiations, European Western Balkans, 29 May, 2019, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/05/29/ec-albania-north-macedonia-open-negotiations/>

¹³⁶Për detaje shih, për shembull, EU blocks Albania and North Macedonia membership bids, BBC News, October 18, 2019, <https://www.bbc.com/news/world-europe-50100201>

¹³⁷ Marrëveshja e Stabilizim Asocimit midis BE-së dhe Kosovës, <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf>

¹³⁸ Neni 7, Traktati i Unionit Evropian.

¹³⁹ Vienna Convention on the Law of Treaties, Vienna, 23 May 1969, Entered to force on 27 January 1980, http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969.pdf

njëanshëm përmes shkrirjes së dy shteteve në një shtet të ri, vendet e tjera anëtare mund të konsiderojë që anëtarësitë e Kosovës dhe Shqipërisë në BE kanë pushuar së ekzistuari, dhe që shteti i ri duhet ta fillojë procedurën e aplikimit nga fillimi, gjë kjo që do të mund të kishte konsekuenca të paparishikuara për të dyja vendet.

Për sa i përket modeleve të asocimit midis Kosovës dhe Shqipërisë deri në nivelin e një subjekti juridik ndërkombëtar, për aq sa ato i ndihmojnë procesit të integritit të të dyja vendeve në BE, mund të pritet që Brukseli këto nuk do t'i shikojë me dyshim, si përpjekje për bashkim, por, përkundrazi, do të mund t'i inkurajonte, nëse Kosova dhe Shqipëria do ta qartësonin që nuk kanë intencë të bashkimit në një shtet të përbashkët.

- **Diskutimi i hulumtimit të idesë së bashkimit në raport me konsideratat ndërkombëtare**

Të intervistuarit e këtij hulumtimi, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, kanë qenë të ndarë lidhur me idenë e bashkimit të dy vendeve. Për më tepër, kjo ide me të drejtë është karakterizuar si abstrakte dhe e diskutuar sipërfaqësisht¹⁴⁰, një që në të dyja vendet ka mbetur vetëm në nivelin e dëshirës apo të ëndrrës në diskursin publik¹⁴¹.

Nga ky aspekt, disa nga të intervistuarit mendojnë që popullatat e dy vendeve veten e kanë vështruar si përkohësisht të ndara si pasojë e një gabimi të politikës ndërkombëtare, gjegjësisht, të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës (1913). Për më tepër, si pengesë kryesore në arritjen e bashkimit ata e konsiderojnë mos-arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë¹⁴², ndërsa obligimet kontraktuale ndaj NATO-s dhe BE-së nuk mendohet të jenë pengesa të pakapërcyeshme për bashkimin e dy vendeve.¹⁴³

Nga ky këndvështrim argumentohet që vullneti i bashkimit të një kombi nuk mund të pengohet me asnjë konventë dhe me ligjin ndërkombëtar, pasi bazuar në mendimin këshilldhënës të GJND-së,

¹⁴⁰ Intervistë me Robert Muharremin, Profesor në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK), Prishtinë, 04.06.2019.

¹⁴¹ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar I Këshillit Kombëtar të Nisma Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019.

¹⁴² Intervistë me Arian Starovën, ish-Ministër i Jashtëm i Shqipërisë, Tiranë, 02.09.2019 dhe Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

¹⁴³ Intervistë me Bekim Çollakun, Shef i Kabinetit të Presidentit të Kosovës dhe ish-Ministër për Integritim Evropian, Prishtinë, 12.06.2019, Arian Starovën, ish-Ministër i Jashtëm i Shqipërisë, Tiranë, 02.09.2019, Zef Precin, Qendra Shqiptare për Kërkim Ekonomik, Drejtor Ekzekutiv, Tiranë, 11.09.2019 dhe Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

pavarësia e Kosovës nuk është në kundërshtim me të Drejtën Ndërkombëtare¹⁴⁴. Në këtë aspekt, një qasje e dallueshme rreth idesë së bashkimit nga të intervistuarit është se ajo do të jetë imperativ nëse Kosovës i pamundësohet anëtarësimi në KB, NATO dhe në BE¹⁴⁵. Mirëpo, në anën tjetër, kjo qasje e konsiderohet të jetë shfrytëzim i kësaj ideje si mjet shantazhimi dhe frikësimi të BE-së, meqë bashkimi i dy vendeve konsiderohet se do të duhej të ishte rezultat i suksesit të shtetësisë së Kosovës¹⁴⁶.

Për sa i përket implikimeve rajonale të bashkimit të dy vendeve, nga ky këndvështrim argumentohet që nuk do të kishte pasoja të theksuara rajonale, meqë bashkimi do ta bënte më të sigurtë paqen dhe sigurinë në Ballkan¹⁴⁷, me përjashtim të rastit të Republikës Sërbe, por, i cili do të mund të parandalohej nga faktori ndërkombëtar.¹⁴⁸

Përkundrejt këtyre këndvështrimeve rreth bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë, nga të intervistuarit e tjerë argumentohet që në këtë drejtim nuk duhet ndërmarrë hapa të njëanshëm¹⁴⁹, meqë realizimi i bashkimit të dy vendeve në këtë mënyrë do të ishte i pamundur¹⁵⁰, dhe ky njëkohësisht do të mund të rrezikonte anëtarësinë e Shqipërisë në NATO, si dhe rikthimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB 1244 (1999), e të cilat po ashtu do ta dëmtonin rëndë procesin e integritetit të tyre në BE¹⁵¹.

Për më tepër, edhe pse konstatohet që në aspektin juridik mënyra më efikase për bashkim është absorbimi i Kosovës nga Shqipëria përmes parimit të kufijve të lëvizshëm kontraktualë, ku Shqipëria do të mund të mbetej anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe palë kontraktuale e marrëveshjeve ndërkombëtare para datës së suksedimit¹⁵², megjithatë theksohet se kjo mund të realizohet vetëm duke u bazuar në rregullativat ligjore të organizatave anëtarësinë e të cilave ajo e gëzon, dhe kjo nuk

¹⁴⁴ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019.

¹⁴⁵ Intervistë me Bekim Çollakun, Shef i Kabinetit të Presidentit të Kosovës dhe ish-Ministër për Integritet Evropian, Prishtinë, 12.06.2019 dhe Sotiraj Hroni, Instituti për Demokraci dhe Ndermjetesim, Drejtor Ekzekutiv, Tiranë, 03.09.2019.

¹⁴⁶ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019.

¹⁴⁷ Intervistë me Jakup Krasniqin, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate dhe ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019.

¹⁴⁸ Intervistë, Arian Starovën, ish-Ministër i Jashtëm i Shqipërisë, Tiranë, 02.09.2019.

¹⁴⁹ Intervistë me z. Agron Bajramin, Kryeredaktor i Kohës Ditore, Prishtinë, 10.06.2019 dhe Valon Muratin, Kryetar i Lëvizjes për Bashkim, Prishtinë, 19.06.2019.

¹⁵⁰ Intervistë me Visar Ymerin, Nënkyetar i Partisë Social Demokrate, Prishtinë, 20.06.2019.

¹⁵¹ Intervistë me Hajredin Kuçin, Nënkyetar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe ish Zëvendës-Kryeministër i Kosovës, Prishtinë, 27.05.2019.

¹⁵² Intervistë me Robert Muharremin, Profesor në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK), Prishtinë, 04.06.2019.

mund të ndodhë në asnjë rast si një vendim i vetëm i dy vendeve dhe pa përkrahjen ndërkombëtare.¹⁵³

Nga ana tjetër, shtrohet edhe argumenti i ekzistencës së dy faktorëve që nuk mundën të bashkëjetojnë me idenë e shtetit të Kosovës¹⁵⁴, dhe atë, së pari, etno-nacionalizmi serb, që ekzistencën e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës e ka problem esencial, dhe së dyti, etnonacionalizmi shqiptar, që Kosovën e sheh si krijesë të përkohshme deri në bashkimin me Shqipërinë.¹⁵⁵ Në vazhdë të kësaj linje të argumentimit, theksohet që mënyra më e mirë e bashkimit de fakto të dy vendeve është ajo brenda Bashkimit Evropian dhe NATO-s,¹⁵⁶ dhe kjo mbështetet me faktin që Kosova është ndërtuar si shtet duke u bazuar mbi parimin e mos-bashkimit me vendet e tjera¹⁵⁷. Për më tepër, konsiderohet që kjo ide nuk mund ta ketë për referencë rastin e bashkimit gjerman,¹⁵⁸ dhe, në situatën e tanishme, kur Kosova ka legjitimitet të cunguar ndërkombëtar, bashkimi i dy vendeve do të mund të përceptohej si një bashkim i kamufluar “a lla Krime”¹⁵⁹.

Më tutje, disa të intervistuar konsiderojnë që bashkimi në BE dhe bashkimi në një shtet të përbashkët, janë komplementare, dhe nuk e zëvendësojnë njëri-tjetrin¹⁶⁰. Sipas tyre, ideja e bashkimit është në thelb kontradiktore me atë të integritimit në BE, meqë aspirata për integrim në BE nuk do të kishte kuptim nëse njëkohësisht synohet edhe bashkimi i dy vendeve.¹⁶¹ Për më tepër, argumentohet që Kosovës dhe Shqipërisë i duhet një BE e madhe, dhe jo një “Shqipëri e madhe”, e cila me shumë gjasë do të ishte e izoluar dhe me qeverisje të dobët.¹⁶² Në këtë aspekt, bashkimi i dy vendeve shihet si opsion real vetëm nëse BE-ja pushon së ekzistuar,¹⁶³ apo nëse ndodhin ndryshime të mëdha në skenën ndërkombëtare që do të krijonin rrethana përkrahëse ndaj kësaj ideje¹⁶⁴.

Këta të intervistuar i vejnë në pah edhe pasojat e mundshme regjionale të zbatimit të këtij opcioni në rrethanat e tanishme, me ç'rast do të mund të vihej në lëvizje një proces i pakontrolluar i ribërjes së

¹⁵³ Intervistë me Gazmend Oketan, ish Zëvendës Kryeministër, Tiranë, 06.09.2019 dhe Ilir Kalemaj, Zëvendës Rektor i Departamentit të Shkencave Sociale, Universiteti i Nju Jorkut Tiranë, Tiranë, 15.07.2019.

¹⁵⁴ Intervistë me Arben Hajrullahun, Profesor në Universitetin e Prishtinës, Prishtinë, 28.05.2019.

¹⁵⁵ Mendime të ngjashme ka edhe Nexhmedin Spahiu, Profesor në Kolegjin AAB, Intervistë, Mitrovicë, 01.07.2019.

¹⁵⁶ Intervistë me Përparim Kabon, Profesor në Universitetin Mesdhetar, Tiranë, 09.09.2019.

¹⁵⁷ Intervistë me Remzi Lanin, Instituti Shqiptar i Medias, Drejtor Ekzekutiv, Tiranë, 02.09.2019.

¹⁵⁸ Intervistë me Arben Hajrullahun, Profesor në Universitetin e Prishtinës, 28.05.2019.

¹⁵⁹ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 10.06.2019.

¹⁶⁰ Intervistë me Genc Rulin, ish Ministër i Financave, Tiranë, 15.09.2019 dhe Zef Precin, Qendra Shqiptare për Kërkim Ekonomik, Drejtor Ekzekutiv, Tiranë, 11.09.2019.

¹⁶¹ Intervistë me Tonin Gjuraj, Profesor, Universiteti Europian i Tiranës, Tiranë, 02.09.2019.

¹⁶² Intervistë me Arta Dade, ish-Ministre e Punëve të Jashtme, Tiranë, 16.09.2019.

¹⁶³ Intervistë me Marko Bello, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Tiranë, 02.09.2019.

¹⁶⁴ Intervistë me Jetlir Zyberaj, Këshilltar i Ministrit të Jashtëm të Kosovës, Tiranë, 21.06.2019.

hartave të Ballkanit Perëndimor,¹⁶⁵ meqë kjo do të mund ta hapte edhe të ashtuquajturën “Kuti të Pandorës” për ndryshimin e kufijve sipas kritereve etnike¹⁶⁶. Një ndryshim i tillë i kufijve do të mund ta prekte Bosnjen e Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Greqinë,¹⁶⁷ dhe kjo do të shkaktonte jostabilitet të lartë rajonal,¹⁶⁸ përfshirë këtu edhe mundësinë e hapjes së çështjes së Vorio-Epirit nga Athina¹⁶⁹.

Në rrjedhën e këtij argumentimi, konsiderohet që ideja e bashkimit nuk duhet të shtrohet fare, meqë ajo do ta dëmtonte rëndë, si Shqipërinë, ashtu edhe Kosovën,¹⁷⁰ duke pasur parasysh faktin që është e papranueshme për akterët kyç perëndimorë dhe gjeopolitikën rajonale,¹⁷¹ dhe pasi ajo i hapë dyer rikthimit të ndikimit madhor të Rusisë në Ballkan¹⁷²

¹⁶⁵ Intervistë me Aldo Bumçin, ish-Minister i Drejtësisë, Tiranë, 03.09.2019.

¹⁶⁶ Intervistë me Jetlir Zyberaj, Këshilltar i Ministrit të Jashtëm të Kosovës, Prishtinë, 21.06.2019.

¹⁶⁷ Intervistë me Dalibor Jevtić, Zëvendës Kryeministër i Kosovës, Prishtinë, 11.06.2019, Miodrag Milićević, NGO Aktiv, Drejtor Ekzekutiv, Prishtinë, 25.06.2019 dhe Rada Trajković, ish-deputete e Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 08.06.2019

¹⁶⁸ Intervistë me Rada Trajković, ish-deputete e Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 08.06.2019

¹⁶⁹ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 10.06.2019.

¹⁷⁰ Intervistë me Mimi Kodhelin, ish-Ministre e Mbrojtjes, Tiranë, 04.09.2019.

¹⁷¹ Intervistë me Ferdinand Gjani, Rektori i Kolegjit Universitar Beder, Tiranë, 03.09.2019.

¹⁷² Intervistë me Fatmir Mediu, ish-Ministër i Mbrojtjes, 02.09.2019.

Konkluzione

Ideja e bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë, në dy vitet e fundit është një ndër çështjet më të zëshme të diskursit publik në të dyja vendet. Kjo ide, si dhe implikimet e saj për të dyja vendet, nuk janë elaboruar në mënyrë të thellë, dhe ate posaçërisht për sa i përket implikimeve në raport me të Drejtën Ndërkombëtare dhe institucionet kyçe ndërkombëtare, gjegjësisht, Kombet e Bashkuara, NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

Analiza e mësipërme politiko-juridike vë në pah argumentet që nëse këto dy vende do të lëviznin në *mënyrë të njëanshme* dhe pa konsensus të plotë trans-atlantik drejt bashkimit, qoftë me opsionin e absorbimit të Kosovës nga Shqipëria, qoftë me atë të shkrirjes së tyre në një shtet të përbashkët, atëherë kjo do të kishte pasoja fatale për shtetësinë e Kosovës, dhe do t'i dëmtonte rëndë interesat ekzistenciale dhe vitale të Shqipërisë. Në këtë rast Kosova fare lehtë do të mund të pushonte së ekzistuari si shtet, dhe kjo njëkohësisht do të mund të çonte te vendosja e sanksioneve nga Kombet e Bashkuara, përjashtimin nga NATO, dhe bllokimi i procesit të integritimit apo edhe përjashtimin e Shqipërisë nga BE-ja. Në rrethana të tilla, pos asaj që Kosova dhe Shqipëria pa dyshim që do të konsideroheshin nga Perëndimi si vende matrapaze, të ashtuquajtura “rogue states”, Prishtina dhe Tirana do t'i rrezikonin edhe interesat vitale të Perëndimit në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, përfshirë këtu edhe dobësimin e kohezionit të NATO-s dhe të BE-së.

Më tutje, duhet të theksohet që ideja e bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë nuk mund të krahasohet me rastin e bashkimit gjerman, dhe si e tillë, në rrethanat e tanishme, është në kolizion të plotë me idenë e zgjerimit të BE-së, që nuk është e bazuar në parimin e ndryshimit të kufijve, por në atë të integritimit të shteteve brenda ombrellës supra-nacionale të Brukselit. Ndjekja e idesë së bashkimit nga bartësit e institucioneve dhe partitë politike në të dyja vendet do të krijonte pengesa për integritet e tyre në institucionet euro-atlantike, ashtu siç u vërejt me rastin e kushtëzimit të Shqipërisë nga ana e Gjermanisë për heqjen dorë nga ambicjet për bashkim me Kosovën në raport me negociatat për akcesion në BE¹⁷³.

Nga ana tjetër, iniciativat asocuese midis Kosovës dhe Shqipërisë, që nuk do të krijojnë subjekt të ri të të Drejtës Ndërkombëtare, por që do të kishin karakter integruës midis dy vendeve, dhe që do të ishin në linjë me integritet evropiane, me politikën e NATO-s dhe me iniciativat bashkëpunuese

¹⁷³ Berlin warns Tirana: Forget ambitions for Greater Albania (Προειδοποίηση Βερολίνου σε Τίρανα: Ξεχάστε τις φιλοδοξίες για «Μεγάλη Αλβανία»), Skai, 26 September, 2019: <https://www.skai.gr/news/world/proeidopoiisi-verolinou-se-tirana-ksexaste-tis-filodoksies-gia-megali-alvania>.

rajonale, do të mund ta kishin edhe përkrahjen e Brukselit dhe të Washingtonit. Mirëpo, parakusht i domosdoshëm që iniciativat e tilla asocuese të jenë të dobishme për të dyja vendet, dhe të jenë komplementare e jo në kolizion me politikat e perëndimit në rajon, ato duhet të bëhen në mënyrë transparente me akterët politik dhe civil në të dyja vendet, dhe të konsultuara që më parë me NATO-n dhe me BE-në.

V. E ardhmja e marrëdhënieve strategjike midis Shqipërisë dhe Kosovës: Përmbledhje e të gjeturave dhe rekomandime

Shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë asnjëherë nuk kanë jetuar brenda një administrate të përbashkët dhe unike shtetërore. Në kohën e Perandorisë Osmane ata ishin të ndarë në vilajete të ndryshme, ndërkaq, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe Luftërave Ballkanike, ata jetuan për gati një shekull në dy shtete të ndryshme (Shqipëri dhe Jugosllavi). Gjatë kësaj periudhe, komunikimi dhe bashkëpunimi midis tyre ka qenë tejet i kufizuar, për shkak të marrëdhënieve antagoniste ndërshtetërore, si dhe diskriminimit sistematik të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, me përjashtim të periudhës 1968–1989, kur Kosova gëzoi një autonomi të avancuar dhe kishte statusin e njësisë konstituive federale.

Me rënien e Murit të Berlinit ndryshoi konteksti gjeopolitik në Ballkan, gjë që i bëri të mundshme ndryshimet e brendshme në Shqipëri nga një diktaturë e izoluar për disa dekada në pluralizëm politik, dhe solli dezintegrimin e Jugosllavisë. Orientimi pro-perëndimor i shqiptarëve, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, së bashku me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në 1999, krijuan kushtet për fillimin e një bashkëpunimi midis dy vendeve në një kontekst të ri. Kështu u hapën kufijtë, dhe u krijua vizioni i përbashkët për integrimin euro-atlantik. Megjithëse kufijtë midis Shqipërisë dhe Kosovës u hapën, bashkëpunimi formal mes tyre ishte i kufizuar, si pasojë e statusit të papërcaktuar të Kosovës gjatë administrimit të saj nga Kombet e Bashkuara. Me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 këto kufizime u eliminuan dhe për herë të parë në histori, u mundësua bashkëpunimi midis dy vendeve në nivelin ndërshtetëror.

Megjithate, në periudhën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, edhe përkundrejt faktit që të dyja vendet kanë objektiv të përbashkët integrimin euro-atlantik, ato operojnë në rrethana të ndryshme ndërkombëtare në raport me proceset integruese. Shqipëria është vend anëtar i NATO-s që nga viti 2009 dhe vend kandidat për BE që nga viti 2014. Ndërsa, në anën tjetër, Kosova vuan nga legjitimiteti i cunguar ndërkombëtar dhe integrimi i limituar në organizatat ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe mos-antarësimin në OKB dhe mosnjohjen nga pesë vende të BE-së, të cilat i limitojnë në një mënyrë drastike perspektivat e saj për integrimin Euro-Atlantike. Si pasojë, e vetmja arritje e Kosovës ka qenë që në vitin 2015 ta nënshkruaj Marrëveshjen e Asocim-Stabilizimit me Bashkimin Europian, ndërkaq, mundësia për fitimin e statusit të vendit kandidat për antarësim në BE dhe për antarësim në Partneritetin për Paqe dhenë NATO nuk shihen asgjëkund.

Përkundrajt këtyre rrethanave ndërkombëtare, në 12 vitet e fundit Kosova dhe Shqipëria e kanë përjetuar një përparim të theksuar të zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe. Ndërveprimi shtetëror ka pësuar rritje të ndjeshme, përfshirë këtu rritjen e bashkëpunimit ndërqeveritar, institucional, kulturor, shoqëror dhe ekonomik. Në mbështetje të fuqizimit të këtyre marrëdhënieve, janë nënshkruar një numër i madh marrëveshjesh dhe memorandumesh bashkëpunimi. Megjithatë, përkundër marrëveshjeve të arritura midis dy vendeve, funksionaliteti i cunguar, së bashku me stabilitetin e brishtë të institucioneve politike, mungesën e kapaciteteve të administratave shtetërore¹⁷⁴ dhe të konsolidimit të shtetit të së drejtës¹⁷⁵, janë pengesa serioze për zbatimin e ndonjë bashkëpunimi efektiv strategjik midis Kosovës dhe Shqipërisë. Për më tepër, zbatimin e këtyre marrëveshjeve e dëmton edhe tendenca për instrumentalizimin e marrëdhënieve dypalëshe në rrafshin personal nga liderët e dy vendeve, dhe këto shpesh herë marrin ngjyrimë të popullizmit dhe të propagandës¹⁷⁶.

Edhe përkundrajt mangësive në funksionalitetin shtetëror të dy vendeve, krahas me hapjen e temës së shkëmbimit të territoreve në mes Kosovës dhe Serbisë, ideja e bashkimit mes Kosovës dhe Shqipërisë ka qenë një ndër çështjet më të theksuara në diskursin publik në dy vendet gjatë dy viteve të fundit. Në këtë aspekt, në njërin anë konsiderohet se shpejtësia me të cilën Shqipëria do të t'i afrohet anëtarësimit në BE, dhe shpejtësia me të cilën Kosova do ta realizojë anëtarësimin në OKB, dhe më pas në NATO dhe në BE, do ta përcaktojnë kursin e bashkëpunimit strategjik midis dy vendeve, përfshirë këtu edhe mundësinë e bashkimit në një shtet të vetëm,¹⁷⁷ në rast të bllokimit të agjendave integruese. Ndërkaq, nga ana tjetër, konsiderohet që bashkimi midis dy vendeve duhet të jetë kurorëzim i suksesit të shtet-ndërtimit të Kosovës, duke refuzuar qasjen e shfrytëzimit të kartës së bashkimit si mjet shantazhues dhe transakcional ndaj Brukselit në raport me integrimet evropiane¹⁷⁸.

Mirëpo, në rrethanat e tanishme ndërkombëtare, bashkimi Kosovë–Shqipëri me mbështetje ndërkombëtare është i pamundshëm, pavarësisht suksesit apo dështimit të agjendave integruese Euro-Atlantike të dy vendeve. Nëse Kosova dhe Shqipëria lëvizin drejt bashkimit në mënyrë

¹⁷⁴ Intervistë me Genc Rulin, ish-Ministër i Financave, Tiranë, 15.09.2019.

¹⁷⁵ Intervistë me Arta Daden, ish-Ministër e Punëve të Jashtme, Tiranë, 16.09.2019.

¹⁷⁶ Intervistë me Gazmend Oketan, ish Zëvendës Kryeministër, Tiranë, 06.09.2019 dhe Ilir Kalemaj, Zëvendës Rektor i Departamentit të Shkencave Sociale, Universiteti i Nju Jorkut Tiranë, Tiranë, 15.07.2019.

¹⁷⁷ Intervistë me z. Bekim Collaku, Shef i Kabinetit të Presidentit të Kosovës dhe ish-Ministër për Integrimet Evropiane, Prishtinë, 12.06.2019.

¹⁷⁸ Intervistë me Albin Kurtin, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Prishtinë, 10.06.2019.

unilaterale, qoftë me opsionin e aneksimit apo të shkrirjes së tyre në një shtet të ri të përbashkët, kjo do të kishte pasoja të rënda për të dyja vendet, dhe sidomos do ishin fatale për shtetësinë e Kosovës dhe integritetin e saj territorial. Për më tepër, statusi ligjor i “shtetit” të bashkuar nuk do të njihej nga bashkësia ndërkombëtare dhe do të mund të çonte në “rifuqizimin” e Rezolutës 1244 (1999) të KS të KB-së mbi territorin e Kosovës. Kjo, praktikisht, , Kosovën do ta kthente në statusin para vitit 2008, duke e kufizuar kështu vendimmarrjen e saj në kapacitete të ngjashme me ato që gëzonte në qershorin e vitit 1999-të. Pasojat do të ishin dërrmuese edhe për Shqipërinë, e cila do të përballlej me humbjen e anëtarësisë në NATO dhe ndërprerjen e marrëdhënieve me Bashkimin Europian. Praktikisht, kjo do të çonte në vetë-izolim të Shqipërisë.

Me fjalë të tjera, lëvizjet për bashkim do ta vinin në pikëpyetje jo vetëm qëndrueshmërinë, por edhe ekzistencën e dy shteteve, duke e shndërruar këtë në një aventurë të marrë dhe të paracaktuar për të dështuar¹⁷⁹. Një veprim i tillë do të vinte në pikëpyetje interesat kyçe të Perëndimit, pasi ato praktikisht do të shndërroheshin në “Kuaq të Trojës” për Rusinë, veprimet e të cilës në skenën ndërkombëtare, jo vetëm që do të legjitimizoheshin, por do ta merrnin një hov të ri. Po ashtu, qytetarët e dy vendeve nuk do të mbështesnin ide të tilla në këmbim të integritetit në Bashkimin Europian ose në NATO, pasi afrimi me to lidhet ngushtë me rritjen e cilësisë së jetës dhe të stabilitetit. Prandaj, çdo energji e shpenzuar në diskutimin e idesë së bashkimit, është kohë e marrë nga përpjekjet për të zgjidhur çështje jetike me ndikim në jetët e përditshme të qytetarëve të dy vendeve dhe shmangie nga objektivat afatgjata të tyre. Rrjedhimisht, opcioni i bashkimit midis dy vendeve nuk është, as i realizueshëm, dhe as tërheqës, përballë opsionit të rritjes së bashkëpunimit strategjik midis tyre, si dy shtete të pavarura, dhe integriteteve euro-atlantike.

Nga ana tjetër, rritja e kapaciteteve shtetërore të dy vendeve do të përcaktojë progresin jo vetëm të integritetit në strukturat euro-atlantike, por edhe me njëra-tjetrën, dhe do t'i zbehte, si dallimet, ashtu edhe nacionalizmat arkaikë.¹⁸⁰ Në vazhden e kësaj qasjeje, argumentohet që shtyllat e bashkëpunimit strategjik midis Kosovës dhe Shqipërisë duhet të jenë konkurruese, jo kërcënuese për të tjerët, dhe që vlerat dhe standardet evropiane, jo vetëm që nuk e kërcënojnë popullin shqiptar, por, përkundrazi, e ndihmojnë integrimin e tij¹⁸¹.

¹⁷⁹ Intervistë me Enver Hasanin, Profesor në Universitetin e Prishtinës dhe ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 10.06.2019.

¹⁸⁰ Intervistë me Zemaida Mozalin, Lektore në Universitetin e Tiranës, Tiranë, 10.09.2019.

¹⁸¹ Intervistë me Hajredin Kuçin, Nënkyetar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe ish Zëvendës-Kryeministër i Kosovës, Prishtinë, 27.05.2019.

Në këtë proces, Kriteret e Kopenhagës dhe *aquis* i BE-së duhet të shërbejnë si udhërrëfyes të bashkëpunimit ndërshtetëror. *Aquis* do të luante një rol të dyfishtë. Jo vetëm që ky do ta ndihmonte rritjen e mirëqeverisjeve të brendshme, por edhe do ta rriste përgatitjen e Kosovës dhe të Shqipërisë për integrimin në BE, si dhe do t'i forconte kapacitetet e tyre për bashkëpunim të thelluar ndërshtetëror. Përmes kësaj qasjeje, fillimisht do të shmangej rreziku i mospërputhshmërisë së marrëveshjeve bilaterale me *aquis*, dhe do të sigurohej përkrahja e plotë e komunitetit euro-atlantik për bashkëpunimin strategjik mes dy vendeve. Bashkëpunimi strategjik midis dy vendeve duhet ta ketë një qasje harmonizuese me *acquis* që çon drejt integritimit. Që kjo të realizohet, qeveritë e dy vendeve duhet të krijojnë trupa ndërshtetërore përgjegjëse për harmonizimin e politikave integruese mes tyre.

Mirëpo, parakusht për zhvillimin e marrëdhënieve strategjike, të cilat praktikisht ekzistojnë vetëm në letër, është heqja e të gjitha barrierave që ekzistojnë mes dy vendeve. Nga analiza e bërë, fushat më të suksesshme të bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë janë ato ku ka mbizotëruar konkurrenca e lirë. Prandaj, në pjesët që nuk mbulohen nga *aquis*, dhe që kanë të bëjnë me fusha të veçanta të ekonomisë, politikave fiskale, kulturës, rinisë, arsimit, bashkëpunimit ndërkufitar, infrastrukturës strategjike, dhe shkencës, të dy vendet duhet të punojnë së bashku për të krijuar dhe operacionalizuar politika të përbashkëta integruese¹⁸². Kjo duhet të pasohet me identifikimin dhe lëvrimin e avantazheve përkatëse konkurruese që i ka çdonjëri vend, si dhe me ndërtimin e përbashkët të burimeve njerëzore përmes investimeve në hulumtim dhe zhvillim (R&D) në shërbim të rritjes së konkurrueshmërisë rajonale të dy vendeve.

Ndërkaq, sa i përket bashkëpunimit strategjik midis Kosovës dhe Shqipërisë në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, për mbrojtjen dhe avancimin e interesave të të dyja vendeve në këto fusha është i domosdoshëm bashkërendimi nën ombrellën e BE-së dhe NATO-s, në konsultim të ngushtë me SHBA-të si dhe vendet e tjera të Quintit (Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia). Në këtë aspekt, bashkëpunimi strategjik midis Kosovës dhe Shqipërisë duhet të shoqërohet me projektimin e tyre si shtete kredibile dhe aleatë të besueshëm të Perëndimit.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.51:496.5)

327(496.51:496.5)

Dekonstruktimi i Idesë së Bashkimit: E Ardhmja e Marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Shqipërisë / përgatitur nga Lulzim Peci dhe Agon Demjaha, me asistencë të Valdrin Ukshinit. - Prishtinë: KIPRED, 2020. - 61 f.: ilustr. ; 21 cm.

1.Peci, Lulzim 2. Demjaha, Agon 3. Ukshini, Valdrin

ISBN 978-9951-14-063-8

ISBN 978-9951-14-063-8



9 789951 140638